

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children



PLANI I PËRMIRËSIMIT TË VEPRIMTARIVE VJETORE QË KONTRIBUOJNË NË SHËNDETIN E NXËNËSVE

ZVAP Berat

Përmbajtja

AKRONIME	5
1. Hyrje	6
1.1 Qëllimi	7
1.2 Vështrim i përgjithshëm.....	7
1.3 Fushëveprimi dhe kohëzgjatja	7
1.4 Vizioni.....	8
1.5 Misioni	8
1.6 Objektivat.....	8
1.7 Përgjegjësitë	8
2. Vlerësimi i shkollave të ZVAP Berat	10
2.1 Informacion i përgjithshëm.....	10
2.1.1 Ndarja e shkollave sipas Njesisë Administrative të ZVAP Berat.....	10
2.2 Raporti i shkollave private me shkollat publike	11
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	11
2.3.1 Numri i fëmijëve të regjistruar në çdo klasë sipas njesisë administrative.	12
2.3.2 Fëmijët me Aftësi të kufizuar të regjistruar në arsimin bazë	16
2.3.3 Mbrojtja sociale	17
2.3.4 Gjendja shëndetësore dhe sjelljet shëndetësore të nxënësve në bashkinë e Beratit.....	18
2.4 Stafi mësimor në shkolla.....	20
2.5 Infrastruktura.....	20
2.6 Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) Berat	25
2.6.1 Shërbimi shëndetësor në shkolla.....	26
2.6.2 Programi Kombëtar i Kujdesit për Shikimin për fëmijët.....	27
2.6.3 Kalendar i vjetor i aktiviteteve të promocionit shëndetësor në shkolla	27
3. Veprimet për Planin e Përmirësimit.....	31
3.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.	32
3.1.1 Qëllimi kryesor	32
3.1.2 Nën-Objektiva.....	32
3.1.3 Indikatorët e Performancës	33

3.1.4 Lista e veprimeve	33
3.1.5 Lista e projekteve	35
3.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës.....	43
3.2.1 Qëllimi kryesor	43
3.2.2 Nën-Objektiva.....	43
3.2.3 Indikatorët e Performancës	43
3.2.4 Lista e veprimeve	44
3.2.5 Lista e projekteve	44
3.3 Mjedisi fizik në shkollë.....	48
3.3.1 Qëllimi kryesor	48
3.3.2 Nën-Objektiva.....	48
3.3.3 Indikatorët e Performancës	49
3.3.4 Lista e veprimeve	49
3.3.5 Lista e projekteve	50
3.4 Mjedisi social në shkollë.....	53
3.4.1 Qëllimi kryesor	53
3.4.2 Nën-Objektiva.....	53
3.4.3 Indikatorët e Performancës	53
3.4.4 Lista e veprimeve	54
3.4.5 Lista e projekteve	54
3.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit.....	57
3.5.1 Qëllimi kryesor	57
3.5.2 Nën-Objektiva.....	57
3.5.3 Indikatorët e Performancës	57
3.5.4 Lista e veprimeve	58
3.5.5 Lista e projekteve	58
3.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë	61
3.6.1 Qëllimi kryesor	61
3.6.2 Nën-Objektiva.....	61
3.6.3 Indikatorët e Performancës	61
3.6.4 Lista e veprimeve	62
3.6.5 Lista e projekteve	63

3.7 Stafi i shkollës	68
3.7.1 Qëllimi kryesor	68
3.7.2 Nën-Objektiva.....	68
3.7.3 Indikatorët e Performancës	69
3.7.4 Lista e veprimeve	69
3.7.5 Lista e projekteve	70
3.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla.....	73
3.8.1 Qëllimi kryesor	73
3.8.2 Nën-Objektiva.....	73
3.8.3 Indikatorët e Performancës	73
3.8.4 Lista e veprimeve	74
3.8.5 Lista e projekteve	74
4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit Vjetor të Përmirësuar me fokus Shëndetin	76
5. Aneks 1. Raport mbi rezultatet e programit të kontrollit mjekësor bazë (check-up) në rajonin e Beratit.....	77

AKRONIME

ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

NJVKSH- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

CU- Cikël i Ulët

AF- Arsim Fillor

AMU- Arsim i Mesëm i Ulët

DN- Dispozitë Normative

AK- Aftësi e Kufizuar

PEI- Plan Edukativ Individual

OJF- Organizata Jo Fitimprurëse

IA- Institucion Arsimor

DROSHKSH- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor

1. Hyrje

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) ka si detyrë të menaxhojë, të monitorojë, të këshillojë dhe të informojë të gjitha institucionet arsimore dhe burimet njerëzore profesionale në administrimin e tyre, për të përmirësuar dhe për të vijuar më tej me rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor dhe respektimin e ligjeve.

Projekti “*Shkollat për Shëndetin*” ka hartuar një Plan Përmirësimi të Shërbimit i kontekstualizuar në bazë të problematikave që ka ZVAP Berat, duke identifikuar mangësitë dhe nevojat për përmirësimin e shkollave në aspektin shëndetësor. Për ZVAP Berat është bërë vlerësimi i detajuar i shkollave në lidhje me aspekte të sjelljeve shëndetësore, duke u bazuar në tre studime të realizuara nga projekti “*Shkollat për Shëndetin*”: “Indeksi Shëndetësor i Shkollës (SHI)”, “Karakteristikat e Sjelljeve Shëndetësore tek Nxënësit e Shkollave (HBCS)”, dhe “Kompetencat Shëndetësore tek Nxënësit” (Health Literacy, HL), si dhe statistikën zyrtare vjetore që raportojnë vetë shkollat.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit bazë në aspektin shëndetësor. Planin e përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese që lidhen me shëndetin në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjike.

Qëllimi i planit vjetor për përmirësimin e promovimit shëndetësor në shkollë është të ndikojë në shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve nëpërmjet ofrimit të një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetjes në nxitjen e sjelljeve dhe aktiviteteve të shëndetshme.

Kjo mund të arrihet përmes ngritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të nxënësve për rëndësinë e një diete të shëndetshme, aktivitetit fizik dhe higjienës personale, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve dhe evenimenteve shëndetësore në shkollë.

Planifikimi i strategjive të shëndetshme dhe siguri i një mjedisi mbështetës dhe inkurajues mund të ndikojnë në rritjen e kulturës së shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve si dhe integrimin e nxënësve me nevojat të veçanta në shkollë.

Në planin e përmirësimit sugjerojmë shtimin dhe përfshirjen e aktiviteteve të reja në planin e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore, që lidhen me sjelljet e shëndetshme. Propozimi mbi aktivitetet e reja, është shoqëruar me skenarë mbi mënyrën se si këto aktivitete do të zbatohen në praktikë, duke marrë parasysh në çdo rast strukturat, kapacitetet dhe burimet në dispozicion në nivel vendor.

Hartimi i kalendarit të aktiviteteve, u zhvillua duke mbajtur parasysh parimet e mëposhtme:

- qëllimi final (promovimi i shëndetit dhe i mirëqenies së fëmijëve)
- transparenca, qartësia, praktikiteti, dhe fleksibiliteti i ndërhyrjeve
- mandati, përgjegjësitë, gjithëpërfshirja dhe konsultimi i ndërhyrjeve
- shpërndarja dhe konsultimi i gjerë i planit në grupet e interesit
- bashkëpunimi dhe koordinimi
- përshtatshmëria dhe koherenca
- kapacitetet dhe burimet disponibël në nivel vendor

1.1 Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Planit të Përmirësimit me fokus shëndetin është të ndihmojë ZVAP Berat në përmirësimin e procesit të raportimit të shkollave si dhe në integrimin e aktiviteteve në planin vjetor me fokus promovimin e sjelljeve të shëndetshme tek nxënësit e shkollave.

Hartimi i këtij plani ka ardhur si rrjedhojë e identifikimit të nevojave për:

- Ofrimin e një **qasjeje sistematike, të strukturuar, strategjike dhe të qëndrueshme** për promovimin e sjelljeve të shëndetshme dhe krijimin e një kulture shëndetësore në shkolla.
- **Identifikim i prioriteteve:** ZVAP identifikon fushat më të rëndësishme për përmirësim bazuar në të dhëna dhe evidenca, si dhe prioritetizim bazuar në strukturat, kapacitetet dhe burimet aktuale në dispozicion.
- **Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare:** në fushën e Arsimit dhe Shëndetësisë, por edhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e OBSH lidhur me programet e promovimit shëndetësor në shkolla.
- **Qëllimi dhe objektivat specifike** që ZVAP dëshiron/duhet të arrijë në lidhje me promovimin e sjelljeve të shëndetshme. Përpjekjet janë të synuara drejt një rezultati specifik.
- **Sigurimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies:** shkollat janë përgjegjëse për zbatimin e objektivave të identikuara dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ndërhyrja është e qëndrueshme dhe progresi matet.
- **Angazhim proaktiv i të gjitha palëve të interesuara:** nxënësit, prindërit, mësuesit, shërbimi psikosocial dhe ai shëndetësor i shkollës si dhe anëtarët e komunitetit angazhohen në promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

Të gjithë punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët: shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve!

1.2 Vështrim i përgjithshëm

Plani i përmirësimit me fokus shëndetin u hartua duke përdorur të dhënat e marra nga shkollat dhe institucionet e tjera relevante në nivel vendor, nga të cilat u pasqyrua situata aktuale me problematikat që shkollat kanë. Mbi këto problematika u ndërtua plani i përmirësimit mbështetur dhe në atë që parashikojnë aktet ligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1.3 Fushëveprimi dhe kohëzgjatja

Plani synon të përmirësojë procesin vjetor të koordinimit dhe raportimit të veprimtarive dhe aktiviteteve me fokus promovimin e shëndetit tek nxënësit që ndodhin nëpër shkolla me ZVAP Berat. Plani do të implementohet në të gjitha shkollat publike dhe jo publike që ka nën juridikson ZVAP Berat. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tyre do të kujdeset Sektori

i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, pranë Zyrës Vendore Arsimore dhe Burimeve Njerëzore.

1.4 Vizioni

Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies në Arsimin Bazë, nëpërmjet forcimit dhe përmirësimit të shërbimeve të promocionit shëndetësor në shkolla, shtimit të aktiviteteve dhe veprimtarive mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, si dhe bashkëveprimin dhe fuqizimin e lidhjeve të shkollës me komunitetin në tërësi për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

1.5 Misioni

Shtimi dhe përmirësimi i gamës dhe cilësisë së programeve dhe aktiviteteve të promocionit shëndetësor me fokus promovimin e shëndetit dhe mirëqenies për çdo fëmijë të arsimit bazë.

1.6 Objektivat

Impakti në nivel shkollash:

- Rritje e aksesit dhe përodrimit të shërbimeve të promocionit shëndetësor:
Nxënësit do të kenë akses në një sërë shërbimesh të promocionit shëndetësor, duke përfshirë ekzaminimet dentare dhe të syve, imunizimet, dhe shërbimet e shëndetit mendor.
- Rritja e cilësisë së kujdesit shëndetësor:
Plani përfshin qëllime që lidhen me përmirësimin e cilësisë së kujdesit të ofruar nga shërbimet e promocionit shëndetësor në shkollë.
- Adresimi i pabarazive shëndetësore:
Të gjithë nxënësit do të kenë akses në burimet dhe arsimin që u nevojitet për t'u angazhuar në sjellje të shëndetshme.
- Forcimi i edukimit shëndetësor:
Zhvillimi i programeve të edukimit shëndetësor për t'i induktuar nxënësve sjellje të shëndetshme dhe zgjedhje adekuate të stilit të jetesës, përmes krijimit të një kulture shëndetësore në shkollë.

1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës në ZVAP Berat
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtuesit e shkollave (publike dhe jo publike);
 - Mësuesit e shkollave, kryesisht të profileve biologji, edukimi fizik, dituri natyre dhe qytetari;
 - Psikologu/punonjësi social;

- Koordinatorët e shëndetit në shkollë;
 - Mjek/infermier në shkollë;
 - NJVKSH
 - Pushteti vendor (bashkitë)
 - Nxënësit;
 - Prindërit;
 - Komuniteti.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
- ZVAP
 - NJVKSH (rol ndihmës)

Materiali i plotë ndodhet në USB

2. Vlerësimi i shkollave të ZVAP Berat

2.1 Informacion i përgjithshëm

Në ZVAP Berat ka 25 institucione të arsimit bazë, të cilat operojnë veprimtarinë e mësimdhënies në 37 godina. Nga këto, 27 shkolla ndodhen në zone rurale (fshat) dhe 12 prej tyre ndodhen zone urbane (qytet). Nga këto institucione, vetëm 3 shkolla janë private. Shpërndarja e godinave është më e madhe në zonat rurale ku ndodhen 27 shkolla, nga të cilat 14 prej tyre janë shkolla vartëse.

Institucionet e arsimit	Godinat	Shkolla vartëse	Shkolla jo vartëse	Private
25	37	14	25	3

Tabela 1. *Institucionet arsimore në ZVAP Berat*

2.1.1 Ndarja e shkollave sipas Njesisë Administrative të ZVAP Berat

Njësitë administrative përbërëse të qarkut Berat janë pesë, të cilat janë paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën mëposhtë.

Nr.	Njësia administrative	Nr. i shkollave	Nr. fëmijësh total
1	Berat	7 shkolla 9- vjeçare- publike 3 shkolla 9 vjeçare- private 2 shkolla të mesme të bashkuara	3537 fëmijë
2	Roshnik	5 shkolla 9- vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	148 fëmijë
3	Sinjë	5 shkolla 9 –vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	230 fëmijë
4	Velabisht	9 shkolla 9-vjecare 1 shkollë e mesme e bashkuar	667 fëmijë
5	Otlak	5 shkolla 9 –vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	625 fëmijë
			5207 fëmijë

Tabela 2. *Shpërndarja e shkollave në ZVAP Berat*

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, numri më i madh i shkollave publike ndodhen në territorin e Qytetit të Beratit, ndërsa numri më i ulët i shkollave publike ndodhen në Njësitë Administrative Roshnik, Sinjë dhe Otlak. Shpërndarja e shkollave publike sipas zonës gjeografike argumentohet me numrin e popullsisë të përqëndruar në çdo Njësi Administrative dhe nevojën e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç për të përfituar nga shërbimi i arsimit bazë.

2.2 Raporti i shkollave private me shkollat publike

Në Bashkinë e Beratit shkollat private zënë 12% të numrit të shkollave, konkretisht janë 3 shkolla private të cilat ndodhen në qytetin e Beratit. Kurse përqindja e institucioneve arsimore publike është 88%, konkretisht janë 22 institucione të shpërndara në 5 njësitë administrative të Beratit.




Figura 3. Institucionet arsimore të ZVAP Berat sipas sektorit

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

Numri i nxënësve në arsimin bazë nga klasa e parë deri në të nëntë, në shkollat publike dhe private të ZVAP Berat është 5207, prej të cilëve 2497 janë vajza dhe 2710 janë djem. Numri i vajzave të regjistruara në shkollë në total rezulton të jetë më i lartë se numri i djemve.

Numri i nxënësve Total	Nr. i nxënësve në shkollat publike	Nr. i nxënësve në shkollat private	Numri i vajzave	Numri i djemve
5207	4520	687	2497	2710

Tabela 4. Numri total i nxënësve sipas gjinisë

Qyteti i Beratit ka numrin më të madh të nxënësve të regjistruar në shkollë, përkatësisht 3537 nga të cilët 1694 janë vajza dhe 1843 janë djem. Nga të dhënat shohim që numri i djemve të regjistruar është më i lartë se numri i vajzave, përveç në Njesisë Administrative Sinjë ku numri i vajzave është më i lartë, 118 krahasuar me 112 që është numri i djemve. Njësia Administrative Roshnik ka numrin më të ulët të regjistrimeve, 148 nxënës nga ku 71 janë vajza dhe 77 janë djem.




Figura 5. Regjistrimet sipas gjinisë

2.3.1 Numri i fëmijëve të regjistruar në çdo klasë sipas njësisë administrative.

Tabela më poshtë, pasqyron informacion mbi totalin e përgjithshëm të numrit të nxënësve të regjistruar për vitin shkollor 2022-2023, sipas njësisë administrative.

Shohim në figurën 6 dhe 7 numrin më të lartë të regjistrimeve e kanë shkollat e Qytetit të Beratit, pasuar me njësinë administrative Velabishtin dhe Otlak që kanë numër të përafërt regjistrimesh, duke u pasuar me Sinjën dhe Roshnikun që kanë numër shumë të ulët të regjistrimeve.




Figura 6. Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollë nga klasa 1-5




Figura 7. Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollë nga klasa 6-9

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e nxënësve në klasa, nga ku shohim se në arsimin fillor kemi më shumë nxënës në klasat e bashkuara se në arsimin e mesëm të ulët, konkretisht 326 nga të cilat 156 ishin vajza dhe 170 ishin djem, me 225 nxënës nga të cilët 107 ishin vajza dhe 118 ishin djem. Nga këto të dhëna shohim që numri i djemve në çdo klasa është më i lartë se numri i vajzave.

KLASA	ZVA BERAT		
	Gjithsesj	Vajza	Djem
KLASA I	56	26	30
KLASA II	66	25	41
KLASA III	68	33	35
KLASA IV	70	38	32
KLASA V	66	34	32
AF Total	326	156	170
KLASA VI	43	21	22
KLASA VII	64	32	32
KLASA VIII	65	31	34
KLASA IX	53	23	30
AMU Total	225	107	118

Tabela 8. Numri i nxënësve në klasat e bashkuara

Zbatimi i planit për ndjekjen e strategjisë së: *Reduktimi i braktisjes shkollore deri në zero gjatë vitit shkollor 2022—2023 /2023-2024*

Detyrat e ZVAP Berat

- Sigurimi, pasurimi i treguesve statistikore për evidentimin e gjendjes së braktisjes shkollore.
- Evidentimi i të gjithë nxënësve të moshës së detyrimit shkollor dhe përfshirja e tyre në planin e edukimit të shkollës.
- Fuqizimi dhe bashkëpunimi i ZVAP Berat me institucionet e linjës dhe të varësisë për zbatimin e politikave mbështetëse për reduktimin e braktisjes shkollore.

Veprimtarit konkrete

- Kryhet studimi deri në 31 Tetor dhe ndiqet në vazhdimësi.
- Merren statistikatat dhe instrumentat e tjera nga drejtoritë e shkollave.
- Përfshirja në këtë aksion të MASR të të gjithë aktoreve institucionale dhe të shoqërisë civile.
- Bashkëpunimi i psikologut me përfaqësues të shërbimit social në nivel bashkie dhe njësie administrative.

Zbatimi i planit të punës ZVAP Berat (vitit shkollor 2022–2023): *Për integrimin e romëve dhe egjiptianëve*

- Regjistrimi me përparësi i fëmijëve romë dhe ata nga shtresat e pafavorizuara në shkolla, sidomos në zonat e banuara nga popullsia romë:
- Takime me drejtuesit e shkollave të komunitetit rom dhe egjiptian.

Në tabelën e më poshtme pasqyrohet numri total i nxënësve rom në ciklin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët. Nga ku shohim se në ciklin fillor (AF) kemi një numër më të lartë të nxënësve rom se në AMU, konkretisht 56 fëmijë nga ku 28 janë femra. Në arsimin e mesëm të ulët kemi 12 nxënës gjithsej nga ku 4 janë femra.

Nxënës Rom			
Cikli fillor		Arsimi i mesëm i ulët (AMU)	
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
56	28	12	4

Tabela 9. Numri i nxënësve rom

Referuar të dhënave në tabelën më poshtë, shohim se kemi numër më të lartë të nxënësve egjiptian në ciklin fillor AF se në AMU, përkatësisht 277 nxënës nga ku 131 janë femra dhe 233 nxënës nga ku 98 janë femra.

Nxënës Egjiptian			
Cikli fillor		Arsimi i mesëm i ulët (AMU)	
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
277	131	223	98

Tabela 10. Numri i nxënësve egjiptian

Ndjekja e strategjisë kombëtare për: *Integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer nga emigracioni.*

- Ndjekja dhe monitorimi i Strategjisë mbi Integrimin e Shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracionin.
- Përpilimi i të dhënave dhe statistikave mbi fëmijët e regjistruar dhe relatimi i tyre cdo fund 3 muhori në MAS si dhe pasqyrimi i tyre në SMIP.
- Bashkëpunim me shkollat për tu ardhur në ndihmë fëmijëve të regjistruar dhe mbështetje të planeve të veprimtimit të tyre në ndihmë të fëmijëve.
- Ekuivalentimi i lëndëve për nxënësit që kanë studjuar disa vite të shkollës së mesme jashtë shtetit në përputhje me kurrikulën tonë dhe përpilimi i shkresës përcjellëse shkollave pritëse të rrethit.
- Këshillime dhe relati me MAS dhe DRAP Korçë për të dhënat mbi numrin e nxënësve të integruar në shkollat bazë të rrethit.

Tabela 11 tregon numrin e nxënësve të ardhur nga emigracioni, ku numri i nxënësve në AMU është më i lartë se numri i nxënësve në ciklin fillor, përkatësisht 6 nxënës nga ku 2 janë femra me 4 nxënës ku 3 janë femra.

Nxënës të ardhur nga emigracioni			
Cikli fillor		Arsimi i mesëm i ulët (AMU)	
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
4	3	6	2

Tabela 11. Numri i nxënësve të ardhur nga emigracioni

2.3.2 Fëmijët me Aftësi të kufizuar të regjistruar në arsimin bazë

Strategjia Kombëtare “Për personat me aftësi të kufizuar”

- Mbledhja e të dhënave për fëmijët me AK të regjistruar në shkollë.
- Ndjekja me përparësi e plotësimit të objektivave të strategjisë në kuadër të Rregullores nr. 31, datë 28.01.2020 “Për funksionimin e Institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” për arsimin gjithëpërfshirës nëpërmjet hartimit të planeve PEI, trajnimit të mësuesve dhe përmirësimit të infrastrukturës në shkolla.
- Sigurimi i mësuesve mbështetës në shkolla për nxënësit me AK sipas Urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 dhe Udhëzimit nr.30 datë 12.09.2018 për normat mësimore, i ndryshuar.
- Hartimi i një plani veprimi të komisionit të ZVAP Berat për AK dhe mësueset mbështetëse.
- Studimi i nevojave për fëmijët me AK për orë mësimore plus.
- Perpilimi i studimit për numrin e mësuesve ndihmës për të gjithë fëmijët me AK në shkollat normale.

Identifikimi dhe integrimi në shkollë i fëmijëve me AK dhe hartimi dhe zbatimi i PEI për çdo fëmijë me AK të regjistruar në shkollë. Referuar Udhëzimit nr.26, një mësues ndihmës mund të punojë me 2 deri në 3 nxënës me aftësi të kufizuara brenda të njejtut institucion arsimor, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-ve, bazuar në nivelin e vështirësisë dhe nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.

Në tabelën e mëposhtme, shohim se numri i nxënësve të regjistruar në shkollë me aftësi të kufizuar mendore është më i lartë se numri i fëmijëve me problematika fizike, përkatësisht 59 nga ku 22 janë femra dhe 5 fëmijë ku skemi asnjë femër

Nxënës me aftësi të kufizuara arsim bazë publik			
Problematik mendore		Problematika fizike	
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
59	22	5	0

Tabela 12. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara

Në bazë të udhëzimit nr.26, datë 25.11.2019 një mësues ndihmës mund të punojë me 1 deri në 2 nxënës me aftësi të kufizuar brenda të njëjtit institucion arsimor, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-ve, bazuar në nivelin e vështirësisë dhe nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.

Sic paraqitet dhe në tabelën e mëposht numri i mësuesve ndihmës për ciklin e ulët është 21 nga ku 18 janë femra dhe numri i mësuesve ndihmës për AMU është 17 nga ku 12 janë femra.

Mësues Ndihmës			
CU		AMU	
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
21	18	17	12

Tabela 13. Numri i mësuesve ndihmës

2.3.3 Mbrojtja sociale

Bazuar në ndryshimin e fundit në urdhërin nr.313, datë 20.10.2022 për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social, citohet:

- një psikologë/punonjësve për 300-599 nxënës
- dy psikologë/punonjës social për çdo shkollë që ka më shumë se 500 nxënës
- një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 8 nxënës me aftësi të kufizuar të përcaktuara me raport të Komisionit Mjeko-Ligjor.
- në rast se shkollat janë me numër të vogël nxënësish, një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri i nxënësve do të jetë nga 80-299.

Nga tabela mëposhtë shohim që numri i psikologëve në shkollat e arsimit bazë është 8, numri i punonjësve social është 1 dhe numri i oficerëve të sigurisë është 2. Dukshëm duket që numri i punonjësve social dhe i oficerit të sigurisë është tepër i ulët krahasuar me numrin e nxënësve nën përgjegjësinë e ZVAP Berat dhe duhen marrë masa për shtimin e tyre.

Punonjës ndihmës		
Psikolog	Punonjës social	Oficer Sigurie
8	1	2

Tabela 14. Numri i Punonjësve ndihmës

2.3.4 Gjendja shëndetësore dhe sjelljet shëndetësore të nxënësve në bashkinë e Beratit

Sondazhi “HBCS 2022” i realizuar në kuadrin e projektit “Shkollat për Shëndetin” përfshiu një kampion përfaqësues prej 290 nxënësish të klasave 6-9 nga bashkia e Beratit (rreth 38% djem dhe 62% vajza).

Rezultatet kryesore të këtij studimi për bashkinë e Beratit sintetizohen më poshtë:

- *Gjendja shëndetësore:* në tërësi, 55% e nxënësve të shkollave të bashkisë Berat raportuan një gjendje të shkëlqyer shëndetësore të vetë-perceptuar (54% te djemtë kundrejt 56% te vajzat), dhe më tej 39% raportuan një gjendje të mirë shëndetësore. Vetëm 2 nxënës (0.7% e kampionit total) raportuan një gjendje shëndetësore të keqe. Nuk kishte dallime domethënëse gjinore.
- *Ankesat shëndetësore:* prevalenca e ankesave shumë të shpeshta (pothuajse çdo ditë) ishte më e larta për ndjenjën e nervozizmit (rreth 13%), e ndjekur nga irritimi (rreth 8%) dhe më pas nga dhimbja e shpinës dhe trishtimi (rreth 6% secila). Nga ana tjetër, frekuenca ditore ishte më e ulëta për dhimbjet e stomakut dhe ndjesinë e marramendjes (1.0% secila).
- *Konsumimi i mëngjesit:* pothuajse një në pesë nxënës në bashkinë e Beratit (19% në tërësi; 21% te djemtë kundrejt 18% te vajzat) nuk hanin fare mëngjes (d.m.th., 0 ditë në javë). Për më tepër, 2.4% e fëmijëve kishin ngrënë mëngjes vetëm një ditë në javë. Nga ana tjetër, rreth 60% e nxënësve të shkollës në bashkinë e Beratit (62% në femra kundrejt 57% në meshkuj) të përfshirë në anketën e HBCS 2022 raportuan se konsumonin mëngjes gjatë gjithë 7 ditëve të javës. Në përputhje me rezultatet në nivel kombëtar, edhe në bashkinë e Beratit përcaktues të pavarur dhe statistikisht domethënës të një frekuence më të ulët të konsumimit të mëngjesit përfshinin: mosha më e madhe e fëmijëve (klasa e 9-të), vendbanimi në fshat, pakicat rome/egjiptiane, dhe fëmijët me të ardhura të ulëta familjare.
- *Konsumi i frutave:* rreth 42% e nxënësve në bashkinë e Beratit (41% tek vajzat kundrejt 44% tek djemtë) raportuan se konsumonin fruta më shumë se një herë në ditë (d.m.th., më shumë se një racion në ditë) dhe më tej 19% (njëlloj në të dyja gjinitë) raportuan se konsumonin fruta një herë në ditë. Nga ana tjetër, 1.0% e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit raportuan se nuk konsumojnë fare fruta dhe më tej 1.0% më pak se një herë në javë. Përcaktuesit e pavarur dhe statistikisht të rëndësishëm të një frekuence më të ulët të konsumit të frutave përfshinin: gjininë mashkullore, moshën më të madhe të fëmijëve (klasa e 9-të), vendbanimin rural, pakicat rome/egjiptiane, dhe fëmijët me të ardhura të ulëta familjare.
- *Konsumi i perimeve:* 19% e fëmijëve në bashkinë e Beratit (22% tek vajzat kundrejt 14% tek djemtë) raportuan se konsumonin perime më shumë se një herë në ditë (d.m.th., më shumë se një porcion në ditë) dhe më tej rreth 13% (12% në femra kundrejt 16% në meshkuj) raportuan se konsumonin perime një herë në ditë. Në të kundërt, rreth 0.7% e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit raportuan se nuk konsumonin fare perime dhe më tej 2.8% konsumonin perime më pak se një herë në javë.

- *Konsumimi i ëmbëlsirave:* rreth 11% (9% te vajzat kundrejt 15% te djemtë) e nxënësve në bashkinë e Beratit raportuan se konsumojnë ëmbëlsira më shumë se një herë në ditë (d.m.th. më shumë se një produkt i ëmbël në ditë) dhe më tej 18% (21% në femra kundrejt 14% në meshkuj) raportuan se konsumonin ëmbëlsira një herë në ditë. Nga ana tjetër, vetëm 1.7% e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit raportuan se nuk konsumonin fare ëmbëlsira dhe më tej 10% raportuan se konsumonin ëmbëlsira më pak se një herë në javë. Përcaktuesit e pavarur dhe statistikisht domethënës të një frekuence më të lartë të konsumit të ëmbëlsirave përfshinin: gjininë femërore, moshën më të madhe të fëmijëve (klasa e 9-të), arsimin e lartë të nënës, arsimin e ulët të babait, dhe të ardhurat e larta familjare.
- *Konsumimi i pijeve joalkoolike:* rreth 7% (4% tek vajzat kundrejt 11% tek djemtë) e fëmijëve raportuan se konsumonin pije joalkoolike më shumë se një herë në ditë dhe më tej 9% raportuan se konsumonin një lloj pijesh të ëmbëlsuara artificialisht një herë në ditë. Në të kundërt, rreth 8% (9% tek femrat kundrejt 6% tek meshkujt) e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit raportuan se nuk konsumonin fare pije joalkoolike dhe më tej 20% raportuan se konsumonin pije joalkoolike më pak se një herë në javë.
- *Larja e dhëmbëve:* rreth 59% e nxënësve në bashkinë e Beratit (69% tek vajzat kundrejt 41% tek djemtë) raportuan se i lajnë dhëmbët më shumë se një herë në ditë dhe më tej 36% raportuan të lajnë dhëmbët një herë në ditë. Nga ana tjetër, 1.4% e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit (n=4) raportuan se nuk i lajnë dhëmbët fare, dhe më tej 0.7% (n=2) raportuan se i lajnë dhëmbët më pak se një herë në javë.
- *Aktiviteti fizik:* 31% e nxënësve në bashkinë e Beratit (27% tek vajzat kundrejt 38% tek djemtë) raportuan se kryejnë ushtrime të ndryshme fizike çdo ditë (d.m.th., 7 ditë/javë), dhe më tej rreth 5% (4% tek vajzat kundrejt 6% tek djemtë) raportuan të ushtroheshin 6 ditë/javë. Nga ana tjetër, rreth 4% e nxënësve të shkollave në bashkinë e Beratit raportuan se ishin plotësisht sedentarë (d.m.th. të ushtroheshin 0 ditë/javë), dhe më tej rreth 9% ushtroheshin vetëm 1 ditë/javë.
- *Larja e duarve:* 71% e fëmijëve në bashkinë e Beratit (njëlloj te vajzat dhe te djemtë) i lajnë duart shumë shpesh. Për më tepër, rreth 28% e fëmijëve në bashkinë e Beratit i lajnë duart disa herë në ditë. Anasjelltas, vetëm 4 (1.4%) e nxënësve në bashkinë e Beratit raportuan se nuk i lajnë duart fare, dhe më tej 17 (0.2%) e nxënësve raportuan se i lajnë duart shumë rrallë.
- *Lloji i larjes së duarve:* 80% e nxënësve (75% tek djemtë kundrejt 88% tek vajzat) në bashkinë e Beratit i lajnë duart me ujë dhe sapun. Gjithashtu, 19% e fëmijëve në bashkinë e Beratit (24% tek vajzat kundrejt 10% tek djemtë) i lajnë duart me ujë dhe sapun, por përdorin edhe dezinfektues duarsh për mbrojtje të mëtejshme.

Nga ana tjetër, një raport përmbledhës për rezultatet e programit të kontrollit mjekësor bazë (check-up) tek individët adultë në rajonin e Beratit paraqitet në “Aneksin 1” në fund të këtij dokumenti.

2.4 Stafi mësimor në shkolla

Në institucionet arsimore publike, konkretisht në arsimin fillor numri i mësuesve është 177 nga të cilët femra janë 157 dhe meshkuj janë 20. Për arsimin e mesëm të ulët janë gjithsej 278 mësues, nga të cilët 192 janë femra dhe 86 janë meshkuj.

Në institucionet arsimore jopublike, për arsimin fillor kemi 24 mësuese ku të gjitha janë femra, ndërsa për arsimin e mesëm të ulët kemi 19 mësues nga të cilët 11 janë femra dhe 8 janë meshkuj.

ZVAP BERAT	ARSIMI FILLOR			ARSIMI I MESËM I ULËT		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj
IA PUBLIKE	177	157	20	278	192	86
IA JOPUBLIKE	24	24	0	19	11	8
TOTALI	201	181	20	297	203	94

Tabela 15. Numri i stafit mësimor në shkolla

2.5 Infrastruktura

Bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar, sipas nenit 31-një nga detyrat e ZVAP është bshkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore dhe raportimi në DPAP.

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme tregojnë informacionin mbi gjendjen e godinave të shkollave të qarkut Berat, të nxjerra nga inspektimet e kryera nga ZVAP dhe bashkia në fillim të vitit shkollor 2022-2023.

INFORMACION MBI GJENDJEN E GODINAVE TË SHKOLLAVE			
Nr.	Emri i shkollës	Raportimi i ZVAP	Raportimi Bashkisë
1	E Mesme e Bashkuar Sinjë	Shkolla nuk ka roje	F.V dyer të brendshme dhe të jashtme të blinduara, lysterje totale të klasave dhe fasadës si dhe sistemim territori, shtrim oborri me pllaka betoni.

2	9-vjeçare Mjeshove	Shkolla nuk është e rrethuar, nuk ka roje as sanitare, nuk ka fushë sportive të vijëzuar dhe ka lagështi në mure dhe tavane.	Ka nevojë për hidroizolim të soletës.
3	9-vjeçare Levan	Shkolla nuk është e rrethuar, nuk ka roje as sanitare, nuk ka fushë sportive të vijëzuar dhe ka lagështi në mure dhe tavane.	Shkolla është e amortizuar, përbëhet vetëm nga një klasë e bashkuar e cila mirëmbahet.
4	9-vjeçare Bogdan	Shkolla nuk është e rrethuar, nuk ka roje as sanitare	_____
5	9-vjeçare Karkanjoz	Shkolla nuk ka fushë sportive të vijëzuar dhe roje.	_____
6	Kristaq Capo	Shkolla nuk ka fushë sportive të vijëzuar, ka lagështi në mure dhe tavane si dhe i mungon sistemi i ngrohjes.	_____
7	22 Tetori	Shkolla ka lagështi në mure dhe tavane si dhe krisje tavani në katin e tretë, probleme në shkallët e jashtme	_____
8	Thimi Tani	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, nuk ka një oborr të rregullt, nuk ka fushë sportive të vijëzuar dhe ka lagështi në mure dhe tavane	Shkolla ka nevojë për lysterje totale të fasadës
9	Mehmet Ali Vrioni	Shkolla ka lagështi në mure dhe tavane si dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar, ka lagështi në mure dhe tavane	_____
10	"Zihni Toska "	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, ka lagështi në mure dhe tavane si dhe duhet bërë rregullimi i kalçetos, palestres dhe sistemimi i ujërave të bardha.	_____
11	9 vjeçare Otlak	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, ka dëmtime në strukturë, nuk ka roje, nuk ka fushë sportive të vijëzuar si dhe ka shumë lagështi në mure dhe tavane.	Rikonstruksion total i godinës, riparim i çatisë, izolim i xokolit, sistem kullimi dhe drenazhimi. Punime rifinitura dhe suvatime të mureve, tavaneve. Riparim në shtresën e dyshemesë, shtrim me pllaka. Duhet bërë F.V dyer dhe dritare, punime hidraulike dhe rehabilitim total i rrjetit elektrik.

12	Paftal	Shkolla nuk ka roje dhe nuk është e rrethuar, oborri është i parregullt dhe me pengesa, nuk ka fushë sportive të vijëzuar. Ka nevojë për rrethim pasi fusha ku bëhet edhe fizik është buze rruge. Ka nevojë për mur mbajtës në oborr pasi po bien pemët e mbjella sepse ska bazament. Ka nevojë për kënde sportive pasi bëhet baltë nga shirat.	Për shkollën Paftal është e nevojshme rrethimi i shkollës. Rehabilitim të nyjeve sanitare, lysterje të klasave dhe fasadës si dhe sistemim i terrenit sportiv.
13	Mbreshtan	Shkolla nuk ka roje dhe nuk është e rrethuar, nuk ka fushë sportive të vijëzuar. Ka nevojë për rrethim dhe sistemim të këndeve sportive. Ka nevojë për portë hekuri në oborrin e jashtëm.	_____
14	Shyqyri Lakra	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvatë, si dhe ka lagështi në mure dhe tavane	Lysterje totale të shkollës, sistemim i këndit sportiv. Ka filluar dëmtim i shtresës hidroizoluse të soletës dhe ka nevojë për hidroizim.
15	Dushnik	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvatë, ka probleme me dyert dhe dritaret, nuk ka fushë sportive të vijëzuar dhe ka lagështi në mure dhe tavane. Ka problem në rrjetin elektrik ,sepse është i vjetër, ka plasaritje ndërmjet mureve dhe tavaneve.	Rikonstrukcion total. Shkolla ka lagështi prej çatisë dhe xokolit, degradim të shtresave të suvas, duhen zëvendësuar dyert dhe dritaret si dhe ka nevojë për lysterje totale.
16	Qereshnik	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvatë, ka probleme me dyert dhe dritaret, nuk ka roje. Shkolla nuk është e rrethuar, oborri është i parregullt dhe me pengesa dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar. Shkolla ka mungesë energjie dhe uji si dhe ka lagështi në mure dhe tavane. Taraca ka nevojë për izolim sepse pikon në sipërfaqen e saj duke krijuar lagështi në të gjitha klasat dhe rënie suvaje.	Godina është e amortizuar dhe me lagështi. Duhet rikonstrukcion total i godinës. Duhet bërë suvatime dhe lysterje totale. Sistemim i terrenit të jashtëm.
17	Shkolla "Shaban Sollaku"	Shkolla nuk ka roje ai dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar. Nevojitet fusha e sportit dhe një palestër.	_____

18	"Zoi Vangjeli" Velabisht	Shkolla nuk ka roje, oborri është i pa rregullt dhe ka pengesa. Nevojitet një roje pasi shkolla është buzë rrugës automobilistike. Ka mungesë të bazës materiale banka, tabela, kompjutera, soba ngrohje etj.	_____
19	"Sali Llanaj" Veleshnje	Shkolla nuk ka roje, nuk ka sanitare, nuk është e rrethuar si dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar.	Ka nevojë për rrethim të oborrit të shkollës dhe riparim të pjesshëm të çatisë.
20	Molisht	Shkolla nuk ka sanitare dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar.	Ka nevojë për riparim të pjesshem të çatisë.
21	Drobonik	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, ka dëmtime në strukturë, nuk ka roje, nuk është e rrethuar, nuk ka fushë sportive të vijëzuar si dhe ka lagështi në mure dhe tavane.	_____
22	Gjoroven	Shkolla ka dëmtime në strukturë, nuk ka roje, nuk ka sanitare si dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar, gjithashtu ka lagështi në mure dhe tavane.	Emergjente shtrimi i oborrit me pllaka guri dhe rrethimi i Shkollës, ka mungesë të terreneve sportive si dhe duhet investuar në F.V të dyerve dhe dritareve.
23	Bardhaj i Ri	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, nuk ka roje, nuk ka sanitare si dhe nuk është e rrethuar. Nuk ka fushë sportive të vijëzuar, gjithashtu ka lagështi në mure dhe tavane.	Ka nevojë emergjente për forcim të strukturës.
24	Lapardha	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, si dhe me dyert dhe dritaret, gjithashtu ka lagështi në mure dhe tavane. Pllakat lëvizin, shkolla është e palyer, rrjeti elektrik i dëmtuar.	Duhet bërë ndërhyrje në sistemimin e territorit të jashtëm, përforcimit të themeleve dhe linjës drenazhuese.
25	Qoshk	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, ka probleme me strukturën. Shkolla nuk ka roje dhe nuk është e rrethuar, oborri është i pa rregull dhe me pengesa, gjithashtu nuk ka fusha sportive të vijëzuara. Ka lagështi në mure dhe tavane.	F.V dyer të brendshme dhe e jashtme e blinduar, si dhe lyerje totale të fasadës. Ka nevojë për hidroizolim dhe ulluqe si dhe ka nevojë për rehabilitim të kanalizimeve.
26	22 Tetori	Ka lagështi në mure dhe tavane. Ka krisje tavani në katin e tretë, probleme në shkallët e jashtme.	Rikonstruksion i tavaneve tip reskallam në tavan të varur gipsi. Riparime në palestren e shkollës, lyerje

			e të gjitha klasave dhe fasadës, rehabilitim i nyjeve sanitare si dhe mungon sistemi i ngrohjes.
27	Roshnik	Shkolla ka probleme me çatinë dhe suvanë, nuk ka roje, oborri është i pa rregullt dhe me pengesa si dhe nuk ka fusha sportive të vijëzuara. Ka lagështi në mure dhe tavane.	Ka nevojë për investime në: rehabilitim të rrjetit elektrik, shtrim i oborrit me pllaka dhe rrethim i pjesshëm i oborrit. Momentalisht ndodhet në proces hidroizolimi dhe suvatime + lyerje të fasadës.
28	Kostren	Shkolla nuk ka roje, nuk është e rrethuar dhe nuk ka fusha sportive të vijëzuara.	_____
29	Qafe Dardhe	Shkolla nuk ka roje, nuk ka sanitare, nuk është e rrethuar si dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar.	_____
30	Dardhe	Shkolla nuk ka roje, nuk ka sanitare, nuk është e rrethuar si dhe nuk ka fushë sportive të vijëzuar.	_____
31	1 Maji	Ka lagështi në mure dhe tavane. Dyert e emergjences nuk funksionojnë nga brenda	Rehabilitim i sistemit të kullimit në oborrin e shkollës.
32	Duhas	Shkolla nuk ka roje, nuk ka fushë sportive të vijëzuar, ka lagështi në mure dhe tavane.	1. Rikonstruksion i pjesshëm (rifinitura dhe lyerje totale, shtrim i dyshemesë me pllaka, FV dyer/dritare) 2. Shkallë emergjence. 3. Rehabilitim i nyjeve sanitare që ndodhen jashtë godinës 5.f.v porte e jashtme hekur pasi porta ekzistente ka nevojë për shumë riparime.
33	Shkolla Ajet Xhindole	_____	Punime hidroizolimi të soletës, lyerje të klasave dhe pjesërisht fasadës, hidroizolim xokoli në anën perëndimore të objektit. Ka prezencë lagështie në 4 klasa dhe ka nevojë për investime në shtrimin e

			dyshemese me pllaka. Rehabilitim të nyjeve sanitare.
34	Shkolla Bilçe	_____	Territori i shkollës ka nevojë për rrethim.
35	Shkolla Vetterik	_____	Shkolla është në gjendje të mirë, por problematike është situata me kanalizimet në oborrin e shkollës
36	Shkolla Malinat	_____	Rikonstruksion total

Tabela 16. Informacion mbi gjendjen e godinave të shkollave

Nga analizimi i të dhënave të nxjerra nga ZVAP dhe Bashkia shohim që nuk kemi një rakordim midis të dyja institucioneve, prandaj shihet i domosdoshëm bashkëpunimi i tyre mbi analizën e gjendjes infrastrukturore të godinave si dhe prioritizimi i problematikave. Pra shihet i nevojshëm koordinimi i ZVAP dhe bashkisë për të dhënat e infrastrukturës.

2.6 Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) Berat

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat është institucion publik, profilaktik kurativ, pjesë e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, në varësi të DROSHKSH Elbasan. Ajo vepron në zbatim të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ajo është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi të lartë dhe akses të barabartë për gjithë popullatën e njësisë administrative ku ushtron aktivitetin e saj.

Në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe aktiviteteve promovuese shëndetësore përfshihe të gjithë. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të marra nxitin në çdo kohë përmirësimin e faktoreve të jashtëm dhe të brendshëm nga të cilët përfiton komuniteti.

Në tabelën e më poshtme paraqiten testimet e kryera në vitin 2022 sipas muajve të vitit, nga ku janë testuar në total 873 femijë (nxënës shkolle/kopshte) të dyshuar si të prekur me Covid-19 nga të cilët rezultuan pozitive 431 prej tyre (49 %). Pjesa me e madhe janë identifikuar nga hetimi epidemiologjik.

Muaji	Nr. Total i testeve	Nr. Total i rezultateve pozitive
Janar	339	111

Shkurt	81	34
Mars	15	2
Prill	12	8
Maj	0	0
Qershor	6	3
Korrik	234	175
Gusht	131	86
Shtator	27	11
Tetor	15	1
Nentor	4	0
Dhjetor	9	0
Totali	873	431

Tabela 18. Numri testimeve në nxënës shkolle dhe rezultatet pozitive për COVID-19

- Në 3 mujin e parë të vitit 2023 janë testuar 32 fëmijë dhe ka rezultuar pozitiv 1 prej tyre (3%). Rasti pozitiv është evidentuar si kontakt familjar.
- Nëse krahasojmë 3 mujin e parë të vitit 2022 (33.7%) dhe 3 mujin e parë të vitit 2023 (3%) shohim se kemi një rënie të dukshme të pozitivitetit. Aktualisht kemi një përmirësim të situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar depistime në klasat e para dhe të dyta të shkollave të Bashkisë Berat për praninë e sëmundjeve infektive. Nga depistimet e kryera janë evidentuar raste me Variçelë. Gjithashtu nga mjeket e familjes janë raportuar raste me Variçelë dhe Scabies (shkolla Roshnik, Bashkia Berat).

Janë realizuar depistime për higjenën personale të fëmijës dhe janë evidentuar raste me parazite të kokës. Për çdo të konstatuar është komunikuar me drejtuesit e Institucioneve arsimore dhe janë dhënë rekomandime që fëmija të rifillojë frekuentimin e shkollës vetëm pas miratimit nga mjeku i familjes.

2.6.1 Shërbimi shëndetësor në shkolla

Shërbimi i promocionit shëndetësor në shkollat e Beratit ofrohet nga 3 infermier shkollash pranë shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor. Nga ku 12 shkolla të cilat marrin këtë shërbim ndodhen në zonë urbane, pjesa tjetër 13 shkolla që ndodhen në zonë rurale marrin shërbimin shëndetësor nga personeli shëndetësor i ambulancave përkatëse. Në total 3957 fëmijë marrin shërbim të promocionit shëndetësor në shkolla.

Në zonat urbane vështiresia qëndron në mbulimin e plotë të shërbimit me infermier, pasi për 3 infermieret e shkollave është e vështirë prezenca në kohën optimale. Infermieret e shkollave punojnë me grafik javor gjë e cila sjell vështirësi në organizimin e punës në shkollat përkatëse.

Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për infermieret e shkollave sjell kufizimin e dhënies së informacioneve të reja si dhe mangësi në mënyrën e trajtimit të temave në ambientet e shkollave.

Depistimi i një numri të caktuar sëmundjesh në këtë grupmoshë bëhet me mbështetjen e mjekëve të qendrave shëndetësore të zonave ku ata ofrojnë shërbim.

Depistimi i skoliozës, i shikimit dhe i dentistrisë janë tre shërbime të cilat çdo mjek, infermier dhe stomatolog ofron në çdo shkollë.

- Në shkollat e qytetit janë kryer 7951 depistime stomatologjike në grupmoshën 6-16 vjeç.
- Aktivitet edukuese nga shërbimi stomatologjik janë rritur me 30% më shumë se vitet e kaluara.
- Numri i nxënësve në zonat urbane që kanë përfituar nga aktivitetet edukuese nga promovimi shëndetësor ka qenë 100% vitin akademik 2021-2022.

2.6.2 Programi Kombëtar i Kujdesit për Shikimin për fëmijët

Programi Kombëtar i Kujdesit për Shikimin për Fëmijët është një program universal që garanton depistimin e shikimit tek fëmijët 6-14 vjeç. Depistimi u krye në shkollat 9 vjeçare, në klasat e 3, 5, 7 dhe 9 nga mjekët e familjes të trajnuar për këtë proces përgjatë muajit maj dhe qershor. Mjeku pasi kryen vizitën me secilin nxënës, jep këshillat dhe nëse është e nevojshme rekomandon për një vizitë më të specializuar te okulistit. Gjatë vitit 2022, janë depistuar 3973 dhe janë referuar 232 nxënës për vizitë specialist (**6% e nxënësve**). Kjo përqindje mund të atribuohet dhe përdorimit të mjeteve teknologjike.

2.6.3 Kalendar i vjetor i aktiviteteve të promovimit shëndetësor në shkollë

Nr.	Detyrat kryesore / Aktivitetet kryesore	Veprimet për realizimin e tyre	Afati kohor
-----	---	--------------------------------	-------------

1	Aktivitet në shkollën “22 Tetori” në Ditën Botërore të Dëgjimit.	Vendodhja (ambjentet e shkollës “22 Tetori”, “1 Maji”, “Ajet Xhindole”). Informim teorik me anë të power point. Shpërndarje të fletëpalosjeve.	10.03.2023
	Aktivitete në Shkollat 9-vjecare të qytetit për “Higjienën Orale” dhe “Higjienën Personale”	Vendodhja (Shkolla “28 Nëntori”, “Mehmet Ali Vrioni”, “Zihni Toska”, “22 Tetori”, “1 Maji”, “Shyqyri Lakra”, “Thimi Tani “, “Xhemal Cekini”, “Drita e Dijes”, “Irfan Ngjeqari” etj. Informim të fëmijëve për këto tema me anë të lojrave të ndryshme.	09-21.03.2023
2.	Aktivitete me mësues të ciklit fillor për muajin e Ndërgjegjësimit për autizmin	Vendodhja (në ambjentet e shkollave “28 Nëntori”, “Ajet Xhindole” dhe “Thimi Tani”) Shpërndarje informacioni me anë të fletëpalosjeve dhe powr point.	24-30 .04.2023
	Aktivitet me nxënësit e shkollave të qytetit me rastin e Ditës Botërore të Aktivitetit Fizik dhe Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe	Kordinimi i aktivitetit. Vendodhja (në qendrën e qytetit) Logjistika Shpërndarje informacioni (në mënyrë verbale, në mënyrë elektronike dhe rrjeteve sociale)	06.04.2023

3.	Aktivitet me tema: Dita Botërore e Melanomës Dita Botërore e Astmës Dita Botërore e Talasemisë	Vendodhja (shkollat: “Babë Dudë Karbunara”, “Kristaq Capo”, “Kristo Isak”, “Stiliano Bandilli” etj)	02.05.2023 03.05.2023 08.05.2023
	Aktivitet në terren në Ditën Botërore pa Duhan	Vendodhja (shkollat: “Babë Dudë Karbunara”, “Kristaq Capo”, “Kristo Isak”, “Stiliano Bandilli”, “Zihni Toska”, “Drita e Dijes”, “Xhemal Cekini” etj)	22-31.05.2023
4.	Aktivitet për pastrimin e qytetit në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit në bashkpunim me shkollat “Ajet Xhindole” dhe “Kristaq Capo”	Vendodhja (Lagje të qytetit) Kordinimi i aktivitetit. Shpërndarje fletëpalosjesh	05.06.2023
	Aktivitet për Ditën Botërore Kundër Punës së fëmijëve.	Vendodhja (Shkolla “1 Maji”)	12.06.2023
	Aktivitet në terren për Ditën Botërore Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave “22 Tetori”, “1 Maji”, “Babë dudë Karbunara” dhe “Ajet Xhindole”.	Vendodhja (pedonalja e qytetit.)	26.06.2023
5.	Aktivitet për Ditën Botërore të Ndhmës së Parë.	Vendodhja (Shkolla Kristaq Capo) Marrja e informacioneve praktike për ndihmën e parë. Llojet e teknikave për dhënien e ndihmës së parë.	09.09.2023

	Aktivitet për Ditën Botërore të Kontracepsionit.	Vendodhja (Shkolla “Babë Dudë Karkunara”) shpërndarje informacioni me fletëpalosje dhe poëer point.	26.09.2023
6.	Aktivitetë për Ditën Botërore të Parandalimit të Abuzimit ndaj Fëmijëve.	Vendodhja (Shkolla Kristo Isak dhe Babë Dudë Karbunara)	19.11.2023
	Aktivitetë për Ditën Botërore për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.	Vendodhja (, shkolla si: “28 Nëntori”, Mehmet Ali Vrioni”)	25.11.2023
	Fushata Kombëtare e 16 Ditëve të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.	Vendodhja (Shkolla “Ajet Xhindole”, “Kristaq Capo”, “Babë dudë Karbunara”)	25-10.12.2023
	Aktivitete me temë Kanabisi.	Vendodhja (Shkolla “1 Maji”, “Thimi Tani”, “22 Tetori” dhe “Shyqyri Lakra”)	03.11.2023 10.11.2023 17.11.2023 24.11.2023
7.	Aktivitetë për Ditën Botërore të AIDS.	Vendodhja (Shkolla Ajet Xhindole)	01.12.2023
	Aktivitet për Ditën Botërore Të personave me Aftësi Ndryshe.	Vendodhja (Shkolla Kristaq Capo)	03.12.2023
	Aktivitet për Ditën e të Drejtave të Njeriut	Vendodhja (Shkolla “22 Tetori”, “Xhemal Cekini”)	10.12.2023
	Aktivitete për Luftën Kundër Trafikimit të Personave.	Vendodhja (Shkolla “Zihni Toska”, “Stiliano Bandilli”, Ajet Xhindole” dhe “Shyqyri Lakra”)	16-31.12.2023

Tabela 19. Kalendari i aktiviteteve të NJVKSH Berat

- Rekomandohet që kalendari i aktiviteteve të NJVKSH të rakordohet me planet e aktiviteteve në shkolla, në mënyrë që të kemi një qasje dhe një përfshirje më të gjerë të nxënësve që marrin pjesë në aktivitete.
- Gjatë organizimit të aktiviteteve me stafin e NJVKSH-së mësuesit pjesmarrës mund të zhvillojnë trajnime të brendshme me pjesën tjetër të stafit mësimor, për të shkëmbyer njohurit dhe kapacitetet e tyre në drejtim të njohurive mbi shëndetin.
- Në shkollat e Beratit ka vetëm 3 infermiere, të cilat e kanë të pamundur të mbulojnë të gjitha shkollat me aktiviteteve që lidhen specifikisht me “promocionin shëndetësor”, prandaj rekomandohet të riorganizohet stafi shëndetësor në shkolla, sidomos për shkollat në zonat rurale, për të patur mbulim gjithëpërfshirës.
- Rekomandohet që stafi i NJVKSH të promovojnë shëndet duke ndihmuar mësuesit të përshtasin temat sipas kurrikulës aktuale dhe të integrojnë konceptet e lidhura sjelljet e shëndetshme gjatë orëve mësimore të dedikuara temave shëndetësore.
- Rekomandohet që stafi i NJVKSH të ofrojë seanca këshillimin ndaj mësuesve në mënyrë që të angazhojnë nxënësit e tyre në "aktivitete argëtuese" që inkurajojnë një stil jetese të shëndetshëm.
- Rekomandohet shtimi, forcimi dhe përmirësimi i programeve/ndërhyrjeve/aktiviteteve që lidhen specifikisht me “promocionin shëndetësor” në shkollat 9-vjeçare.

3. Veprimet për Planin e Përmirësimit

Plani i përmirësimit me fokus shëndetin do të hartohet duke u bazuar në tetë komponentët kryesorë të Indeksit Shëndetësor të Shkollave, të evidentuar për vlerësimin e shkollave në aspektin e shëndetit.

- 1.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.
- 1.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës
- 1.3 Mjedisi fizik në shkollë
- 1.4 Mjedisi social në shkollë
- 1.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit
- 1.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë
- 1.7 Stafi i shkollës
- 1.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

3.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e stafit
- Shkolla vlerëson sjelljet shëndetësore të nxënësve
- Shkolla identifikon nevojat shëndetësore dhe dëshirat e nxënësve dhe stafit mësimor
- Shkolla ka një person përgjegjës për çështjet e shëndetit

3.1.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Rritja e kapacitetit të shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

3.1.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike, psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve të shkollave 9-vjeçare në administrimin e ZVAP Berat.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike dhe psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor të shkollave 9-vjeçare në administrimin e ZVAP Berat.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Shkollat raportojnë tek ZVAP Berat, konkluzionet e anketimeve/sondazheve/pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.
- ✚ **Nën-Objektivi 4:** Fuqizimi i rolit të koordinаторit të shëndetit në shkolla.

3.1.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien fizike të nxënësve.		
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien psiko- emocionale të nxënësve.		
Përqindja e shkollave që raportojnë mbi mirëqenien psiko- emocionale të stafit të shkollës.		
Përqindja e shkollave që raportojnë konkluzionet e anketimeve mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve.		
Numri i psikologëve, punonjësve social në shkolla, për numër nxënësish		
Numri i mjekëve/infermiereve në shkolla, për numër nxënësish		
Numri i oficerave të sigurisë në shkolla, për numër nxënësish		
Numri i mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë		
Përqindja e shkollave që caktojnë koordinator shëndeti		
Përqindja e shkollave që raportojnë aktivitete të promocionit shëndetësor të organizuara/koordinuara nga koordinatori shëndetësor		
Përqindja e shkollave që raportojnë matjet antropometrike tek ZVAP		

3.1.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
-----	---------------	---------	------------

1.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien fizike të nxënësve nga ZVAP për shkollat që mbulojnë.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve.	Stafi shëndetësor (mjeku/infermieri, dentist)
2.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve, nga ZVAP për shkollat që mbulon.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve, sipas udhëzuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Stafi shëndetësor (psikologu/punonjësi social, mësuesi ndihmës dhe oficeri i sigurisë).
3.	Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirqënien psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor, nga ZVA për shkollat që mbulon.	Raportimi periodik mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve, sipas udhëzuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Stafi shëndetësor (psikologu/punonjësi social, mësuesi ndihmës dhe oficeri i sigurisë).
4.	Shkollat raportojnë tek ZVA, konkluzionet e anketimeve/sondazheve/pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.	Pas çdo pyetëso/ anketimi duhet të raportohet në formë narrative/satistikore konkluzionet e nxjerra, duke ruajtur anonimitetin e nxënësve.	Drejtori i IA
5	Fuqizimi i rolit të koordinаторit të shëndeti në shkollë.	Koordinator i shëndetit është përgjegjës për koordinimin dhe harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit të zbatuara në nivel shkolle.	Drejtori i IA

3.1.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Raportimi periodik nga shkollat tek ZVA në lidhje me mirëqenien fizike të nxënësve.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Stafi shëndetësor (mjekë, infermier) duhet të raportojnë në mënyrë periodike 3 herë në vit, çdo periudhë, mbi të gjitha aktivitetet, anketimet/pyetësorët që zhvillon me nxënësit. Gjithashtu raportimi i emergjencave të nxënësve në shkolla duhet të jetë i menjëhershëm dhe bazuar në udhëzimet e marra për format e raportimit të tyre.	
i. Situata: Ka mungesa dhe mangësi në raportimin në mënyrë periodike mbi aktivitetet që zhvillohen në kuadër të promocionit shëndetësor, vizitave rutinë apo anketimeve/pyetësorëve që stafi shëndetësor zhvillojnë me nxënësit. Drejtuesit e shkollës nuk kanë dokumentacion mbi anketimet apo vizitat shëndetësore që zhvillon stafi i NJVKSH-së.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Ka mangësi në raportimin në formë statistikash apo narrative, tek ZVA mbi aktivitetet e zhvilluara në kuadër të promocionit shëndetësor dhe gjendjen shëndetësore të nxënësve në shkolla. Duke mos patur një panoramë të situatës aktuale, të gjendjes shëndetësore të tyre. Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën shëndetësore të nxënësve.	
ii Synimi i projektit Duke u bazuar në situatën aktuale të raportimit të shkollave, synohet rritja e numrit të raporteve nga drejtori i IA tek ZVAP.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Për çdo aktivitet, vizitë shëndetësore apo pyetësor që stafi shëndetësor zhvillon me nxënësit të dokumentohet, në mënyrë narrative apo statistikore, me informacionet kryesore shëndetësore në të.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Drejtuesi i IA raporton tek ZVAP gjendjen shëndetësore të nxënësve, si dhe numrin e veprimtarive që zhvillohen në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit të nxënësve 6-16 vjeç.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Mjekë/infermier, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

Nr. 2	Projekti: Raportimi periodik nga shkollat tek ZVAP, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Punonjësit social, psikologët duhet të raportojnë në mënyrë periodike, 3 herë në vit çdo fund periudhë, mbi çdo veprimtari, pyetësorë/sondazhe që zhvillohet me nxënësit, si dhe raportimi i emergjencave të nxënësve në shkolla sipas udhëzuesit për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.	
i. Situata: Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të nxënësve si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve, aktivitete psikosociale me nxënësit, etj. Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhëzuesit duke mos patur një panoramë të sitatës aktuale, të mirëqenies psiko-emocionale të tyre: • Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara • Raportimi për veprimtaritë parandaluese • Raporti për aktivitetet vlerësuese Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të nxënësve.	
ii Synimi i projektit Në bazë të veprimtarive që shërbimi psiko-social zhvillon me nxënësit të bëhet raportimi periodik, nga ku synohet rritja e numri të raporteve.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.	
Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Drejtuesi i IA të raporton tek ZVAP në lidhje me mirëqenien psiko-emocionale, si dhe numrin e veprimtarive që zhvillohen në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit mendor të nxënësve 6-16 vjeç.	

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)	
---	---	--

Nr. 3	Projekti: Raportimi periodik nga shkollat tek ZVA, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Punonjësit social, psikologët duhet të raportojnë në mënyrë periodike, 3 herë në vit çdo fund semestri, mbi çdo veprimtari, pyetësorë/sondazh që zhvillohet me stafin mësimor, si dhe raportimi i emergjencave të stafit mësimor në shkollë sipas udhëzuesit për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.	
ii. Situata: Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të stafit mësimor si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve etj. Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhëzuesit duke mos patur një panoramë të situatës aktuale, të mirëqenies psiko-emocionale të tyre: • Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara • Raportimi për veprimtaritë parandaluese • Raporti për aktivitetet vlerësuese Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të stafit mësimor.	
ii Synimi i projektit Në bazë të veprimtarive që zhvillon shërbimi psiko-social, synohet rritja e numri të raportimeve.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.	
Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	

Drejtuesi i IA raporton tek ZVAP në lidhje me mirëqenien psiko-emocionale në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit mendor të stafit mësimor.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)	

Nr. 4	Projekti: Kryerja e pyetësorit të HBCS nga psikologu/punonjësi social
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Çdo vit duhet zhvilluar pyetësi i HBCS nga psikologu/punonjësi social.	
iii. Situata: Në shkollë psikologu/punonjësi social zhvillon disa pyetësor në vit me nxënësit, prindërit dhe mësuesit me temë: “Bullizmi” “Dhuna” etj. Por nuk zhvillohet asnjë pyetësor që të vlerësoj sjelljet e shëndetshme të nxënësve, njohuritë mbi konceptet shëndetësore si dhe ekspozimin ndaj sjelljeve të rrezikshme. Prandaj propozohet të zhvillohet pyetësori i HBCS çdo vit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim Psikologu dhe punonjësi social mbështesin sigurimin e mirëqenies së nxënësve dhe përmirësimin e sjelljes së tyre. Ata zhvillojnë pyetësorë/anketa/intervista/fokus grupe me nxënësit, prindër dhe mësues, me qëllim që të njihen me këndvështrimet e tyre në lidhje me mirëqenien dhe sjelljen e nxënësve në shkollë. <i>Arsyet pse duhet të zhvillohet HBCS çdo vit në shkollë:</i> Përmes informimit mbi sjelljet e shëndetshme të nxënësve, njohurive mbi konceptet shëndetësore dhe ekspozimit ndaj sjelljeve të rrezikshme, identifikohet situata aktuale dhe masat që duhet të merren për të përmiruar këtë gjendje. Promovimi i sjelljeve të shëndetshme dhe të sigurta mes nxënësve është një pjesë e rëndësishme dhe themelore e misionit të shkollave, për t'u siguruar të rinjve njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të qendruar të shëndetshëm dhe produktiv në të ardhmen. Përmirësimi i shëndetit të nxënësve mund të rrisë kapacitetin e tyre për të mësuar, për të ulur numrin e mungesave në shkollë si dhe të përmirësojnë aftësinë e tyre fizike dhe vigjilencën mendore.	
ii Synimi i projektit Të njohim qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve nëpërmjet pyetësorëve, dhe nëpërmjet raportimit ku të dhënat e nxënësve janë konfidenciale.	

Ky pyetësor është ndërtuar për:

- të ndihmuar të gjithë fëmijët në përmirsimin e sjelljeve shëndetësore
- të informuar prindërit rreth situatës shëndetësore të fëmijëve të tyre
- të analizuar situatën shëndetësore të nxënësve dhe për të marrë masa për të përmirësuar shëndetin e tyre si dhe për të nxitur sjellje të shëndetshme tek nxënësit nga klasa e 6-9.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Zhvillimi i pyetësorit mbi vlerësimin e karakteristikave shëndetësore të fëmijëve (HBCS) çdo vit nga psikologu/punonjësi social. Kryerja e pyetësorit mund të bëhet sipas kapaciteteve të shkollave në format letër ose online.

Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Prioritizimi i kërkesave dhe përmirësimimi i kushteve aty ku është e arsyeshme, bazuar në dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve në shkollë.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Psikologu/punonjësi social	Projekti “Shkollat për Shëndetin”
Nxënësit	

f) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

Nr. 5	Projekti: Trajnim i mësuesve të edukimit fizik mbi kryerjen e matjeve antropometrike
-------	---

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit e lëndës së edukimit fizik mbi kryerjen sipas standardit të matjeve të gjatësisë dhe peshës, duke llogaritur dhe BMI-në.

i. Situata:

Në shkolla mësuesit e lëndës së edukimit fizik zhvillojnë trajnime të ndryshme për të rritur njohuritë dhe kapaacitetin e tyre, por nuk kanë kryer asnjë trajnim mbi zhvillimin e matjeve antropometrike sipas standardeve apo për llogaritjen e BMI-së.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Kryerja e matjeve antropometrike duhet të bëhet në mënyrë preçize pasi gabime të vogla në peshë apo gjatësi na japin rezultate të gabuara në përlllogaritjen e BMI-së, prandaj është i

nevojshëm trajnimi i mësuesëve të edukimit fizik mbi matjen sipas standardeve të nxënësve, si dhe siguri i mjeteve të nevojshme si peshore dixhitale dhe metër.									
ii Synimi i projektit Të rrisi kapacitetin dhe njohurit e mësuesve për të zhvilluar matjet antropometrike në mënyrën e duhur duke minimizuar gabimet.									
iii Aktivitetet kryesore të projektit Zhvillimi i trajnimit: “Matjet antropometrike” me të gjithë mësuesit e lëndës së edukimit fizik, në ciklin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.									
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Të gjithë mësuesit e edukimit fizik janë të trajnuar dhe kryejnë matjet antropometrike duke përdorur metodat e standartizuara.									
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - Mësuesit e edukimit fizik - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj) Zhvillimi i trajnimeve nga projekti Projekti “Shkollat për Shëndetin” ose donator të tjerë.								
e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii) Blerja e paisjeve për të realizuar matjet: peshore dixhitale dhe metër <table border="1"> <thead> <tr> <th>Shpenzimet për cdo aktivitet</th> <th>Totali (mijë lekë)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td>Shuma:</td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>		Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)					Shuma:	
Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)								
Shuma:									
f) Periudha e zbatimit:	g) Ndjek zbatimin e projektit:								

Nr. 6	Projekti: Raportimi i matjeve antropometrike
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit e lëndës së edukimit fizik mbi kryerjen e duhur sipas standardit të matjeve të gjatësisë dhe peshës, duke llogaritur dhe BMI-në.	
ii. Situata:	

Mësuesit e lëndës së edukimit fizik dhe shëndet, sipas planit të punës zhvillojnë matje antropometrike, ku bëhet matja e peshës, gjatësi, perimetri i vitheve dhe i belit. Matjet antropometrike zhvillohen 2-3 orë në fillim dhe në fund të vitit dhe hidhen në regjistër, por nuk raportohen tek ZVAP-ja si dhe nuk përlogaritet BMI-ja.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Duhet të kryhet raportimi i matjeve antropometrike, tek ZVA-ja në fillim dhe në fund të vitit kur kryhen sipas planit mësimor, në një format të thjeshtë exceli duke llogaritur BMI. Të dhënat që do ti dërgohen ZVA-së do ruajnë anonimitetin e nxënësve dhe privatësinë e tyre.

ii Synimi i projektit

Raportimi i matjeve antropometrike dhe BMI-së së nxënësve tek ZVAP.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Plotësimi i një tabele të thjeshtë nga mësuesi i edukimit fizik dhe raportimi i saj nga drejtori i IA tek ZVA-ja, si mëposhtë:

Matja e gjatësisë	Matja e peshës	Llogaritja e BMI

c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Dokumentimi i matjeve antropometrike nga çdo shkollë tek ZVA-ja, të cilat më pas janë të vlefshme në hulumtimet shkencore, për të identifikuar faktorët e rrezikut për sëmundjet e lidhura me moshën.

Bashkëpunimi i NJVKSH me ZVAP për të analizuar të dhënat e marra nga matjet e zhvilluara me nxënësit.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - Mësuesit e edukimit fizik - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

Nr. 7

Projekti: Fuqizimi i rolit të koordinatorit të shëndeti në shkollë

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Vendosja e një “Koordinatorit Shëndetësor” konsiderohet thelbësore për të siguruar praninë e një stafi përgjegjës (të caktuar) në çdo shkollë, i cili është përgjegjës për koordinimin dhe

harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit të zbatuara në nivel shkollë.	
iii. Situata: Të gjitha shkollat nën administrimin e ZVAP Berat kanë të vendosur një kooordinator shëndeti në shkollë, i cili duhet të përgjigjet për koordinimin e programeve të edukimit shëndetësor në nivel shkollë.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Përgjegjësia kryesore e Koordinatorit Shëndetësor, ose ndryshe “Oficeri Ndërlidhës Shëndetësor”, konsiston në një bashkëpunim të ngushtë dhe proaktiv me të gjithë stafin përkatës të shkollës, këshillin e prindërve, strukturat drejtuese të fëmijëve, pushtetin vendor, zyrën arsimore vendore, njësinë vendore të kujdesit shëndetësor, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin e përgjithshëm për zbatimin në kohë dhe me efektivitet të planeve vjetore të punës në lidhje me të gjitha ndërhyrjet dhe programet për promovimin e shëndetit të parashikuara në nivel shkollë.	
Ekziston një nevojë urgjente për të lidhur në kohë dhe në mënyrë efektive të gjithë sektorët përkatës dhe për të vendosur fëmijët në qendër. Institucionet publike shëndetësore dhe arsimore u shërbejnë të njëjtëve fëmijë, por ka nevojë për për të bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin dhe për të zbatuar ndërhyrje cilësore dhe efikase ku në qendër të jenë gjithmonë fëmijët.	
Për të arritur këtë qëllim, çdo shkollë ka nevojë të përforcoj rolin e koordinatorit që të ndërlidhë, të ndajë përvojat dhe të promovojë shëndetin brenda mjediseve të shkollës dhe gjithashtu përtej mjedisit shkollor.	
ii Synimi i projektit Fuqizimi i rolit të koordinatorit të shëndetit në shkolla synon promovimin e sjelljeve të shëndetshme në mënyrë të drejtpërdrejtë tek fëmijët dhe, përmes tyre, transmetimin e praktikave të shëndetshme tek prindërit dhe komunitetet në tërësi	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Fuqizimi i rolit të “Koordinatorit të Shëndeti” në çdo shkollë.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Zhvillimi dhe koordinimi i aktiviteteve me fokus sjelljet e shëndetëshme në shkollë, nga koordinatori i shëndeti.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - ZVAP - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)

3.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies si pjesë e qëllimeve edukuese të shkollës
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve si pjesë e kurrikulës shkollore
- Vizioni i shkollës mbi shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve
- Nxënësit, stafi mësimor/ndihmës nxiten të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve shkollore që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien
- Shkolla ka protokolle të qarta në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme

3.2.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Qëllimi kryesor është përfshirja e aktiviteteve me synim promocionin shëndetësor në shkolla.

3.2.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Shkolla përfshin aktivitete kros/ekstrakurrikulare me fokus shëndetin.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Shkolla përfshin në planin vjetor aktivitete që lidhen me sjelljet e shëndetshme.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Shkolla zhvillon sondazhe që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve.
- ✚ **Nën-Objektivi 4:** Shkolla trajnon stafin e saj mbi protokollet në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj).
- ✚ **Nën-Objektivi 5:** Mundësimi i zbatimit të protokolleve të emergjencës nga ana infrastrukturore.

3.2.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Numri i aktiviteteve kros-ekstra-kurrikulare të zhvilluara nga shkollat në kuadër të promocionit shëndetësor.		

Përqindja e shkollave që zhvillon sondazhe që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat e nxënësve.		
Përqindja e stafit që trajnohen mbi shpërthimet epidemike apo fatkeqesi të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)		
Shkollat kanë protokolle për emergjencat, rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)		

3.2.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Shkolla përfshin aktivitete kros dhe ekstrakurrikulare me fokus promocionin e shëndetit.	Propozim i shtimit të aktiviteteve me fokus promocionin shëndetësor në Planin Vjetor të veprimtarive.	ZVA-ja Drejtori i IA
2.	Shkolla zhvillon sondazhe që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve	Kryerja e sondazheve nga psikologu/ punonjësi social	Drejtori i IA Psikologu/ punonjësi social
3.	Shkolla trajnon stafin e saj mbi protokollin në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)	Trajnim me donatorë ose në bashkëpunim me institucionet përkatëse, emergjencat civile, njësitë vendore të shëndetit publik etj.	Drejtori IA Donatorë, emergjencat civile ose NJVKSH-ja
4.	Koordinimi, shkëmbimi i informacionit ndërmjet ZVA dhe bashkisë për përmbytjet e kushteve të duhura infrastrukturore, për të mundësuar zbatimin e protokolleve të emergjencës.	Bashkëpunimi i ZVAP dhe bashkisë për të koordinuar punën gjatë inspektimeve të gjendjes infrastrukturore të godinave	Drejtori i IA ZVAP Bashkia

3.2.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Zhvillimi i trajnimeve për protokollin në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)
--------------	---

a)Përshkrim i shkurtër i projektit:
i. Situata: Shkollat kanë protokolle në raste shpërthimesh epidemike apo fatkeqsive të ndryshme, por stafi i shkollës nuk trajnohet për këto protokolle. Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim
Stafi mësimor i shkollave nuk kanë zhvilluar trajnime mbi protokollat në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj). Trajnimet ju japin mundësi drejtuesve dhe mësuesve të identifikojnë rreziqet që i kanosen nxënësve nga rastet emergjente që mund të ndodhin në shkollë për shkak të rasteve nga zjarri, përmbytjet dhe nga tërmeti. Drejtuesit e shkollës dhe mësuesit i bëjnë pjesë nxënësit në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si dhe të proceseve vendimmarrëse që lidhen me sigurinë e tyre. Gjithashtu trajnimi i jep mundësi drejtuesit të institucionit të krijojnë aftësi për monitorimin dhe vlerësimin e punës që kryhet në shkollë për kujdesin dhe ruajtjen në raste emergjente.
ii Synimi i projektit Rritje kapaciteti të stafit të shkollës për menaxhimin e emergjencave synon ta shndërrojë shkollën në një komunitet të nxëni të orientuar drejt krijimit të një kulture të sigurtë institucionale.
iii Aktivitetet kryesore të projektit Zhvillimi i trajnimeve mbi protokollat e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme me stafin e shkollës.
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Në përfundim të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë të aftë të: - identifikojnë rastet emergjente që ndodhin për shkak të përmbytjeve, zjarrit dhe tërmetit; - shpjegojnë rëndësinë që ka mbrojtja dhe sigurimi nga rreziqet emergjente që lidhen me përmbytjet dhe zjarrit; - identifikojnë mjedisin fizik të shkollës, elementet e saj, mjedisin përreth shkollës që pengojnë ose mundësojnë raste emergjente që lidhen me zjarrit dhe përmbytjet; - shqyrtojnë masat që duhen marrë në kushtet e shtëpisë dhe të shkollës për t'u ruajtur nga zjarri, përmbytja dhe tërmeti; - hartojnë një plan trajnimi për nxënësit për rastet e shpëtimit nga zjarri, tërmeti dhe përmbytjet;

vlerësojnë punën edukative për krijimin e aftësive të nxënësve për t'u ruajtur nga rastet emergjente si zjarri, përmbytjet dhe tërmeti.													
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj) Donator, OJF etj.												
e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)													
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shpenzimet për cdo aktivitet</th> <th>Totali (mijë lekë)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr> <td>Shuma:</td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)									Shuma:		
Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)												
Shuma:													
f) Periudha e zbatimit: Viti akademik 2023-32024	g) Ndjek zbatimin e projektit: ZVAP												

Nr. 2	Projekti: Hartimi i kalendarit të aktiviteteve
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka hartuar një “Udhëzues për kalendarin e aktiviteteve në institucionet arsimore parauniversitare”. Në këtë udhëzues jepen shembuj konkretë të veprimtarive mbi sjelljet e shëndetshme në nivel shkolle ose në nivel klase. Gjithashtu në fund të udhëzuesit do të ketë modele të planeve të veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore për tema specifike.	
i. Situata: Shkollat nuk përfshijnë mjaftueshëm aktivitete që nxisin sjelljet e shëndetshme në planin e tyre të veprimtarive.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Praktikimi i sjelljeve të shëndetshme që në moshë të hershme, u mundëson nxënësve një vazhdimësi të praktikimit të tyre edhe përtej shkollës. Edukimi i vazhdueshëm i nxënësve mbi sjelljet e shëndetshme, sikurse përgatitja e stafit të shkollës, duhet të jenë një proces i planifikuar mirë.	

Udhëzuesi përshkruan njohuritë e nevojshme që i nevojiten një drejtuesi shkolle për të përfshirë në planin e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore edhe sjelljet e shëndetshme, duke përfshirë zakonet e shëndetshme të ushqyerjes, aktivitetin fizik, parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave, promovimin e shëndetit seksual, mendor si dhe praktikatat e mira higjienike dhe masat efektive për parandalimin e sëmundjeve infektive, përfshirë këtu edhe COVID-19.

Aktivitetet e propozuara janë gjithëpërfshirëse në mënyrë që të vihen në zbatim nga të gjitha shkollat, pavarësisht infrastrukturës dhe kapaciteteve të secilës prej tyre. Këto aktivitete kanë qasje praktike, duke patur në qendër nxënësit, prindërit dhe sjelljet e shëndetshme.

ii Synimi i projektit

- Zhvillimi i veprimtarive të planifikuara për praktikimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit të zonës për praktikimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.
- Krijimi i një kulture bashkëpunimi të nxënësve, mësuesve dhe pjesës tjetër të stafit mësimor, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Disa aktivitete/veprimtari që zhvillohen në kuadër të promocionit shëndetësor janë:

20 shtator- Higjiena personale dhe parandalimi i sëmundjeve infektive.

10 tetori-Dita botërore e shëndetit mendor

17 tetor- Dita botërore e urisë

26 tetor- Të ushqyerit e shëndetshëm

10 janar- Edukimi seksual gjithëpërfshirës

2 prill- Dita botërore e autizmit

7 prill- Dita Botërore e Shëndetit

9-12 maj- Java olimpike e sportit etj.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Shtimi i aktiviteteve të propozuara në planin vjetor të veprimtarive të shkollave.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) ZVA Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

f) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

3.3 Mjedisi fizik në shkollë

- Mjediset shkollore janë “miqësore” për fëmijët, të sigurta, të pastra dhe nxisin higjenën personale për të gjithë nxënësit
- Mjediset shkollore janë të përshtatshme për nxënësit, sipas moshës dhe gjinisë, si dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara
- Mjediset shkollore janë të hapuar për aktivitete pas orëve të mësimi
- Mjediset shkollore mundësojnë distancimin fizik
- Përmbushja e standardeve zyrtare të mjediseve shkollore
- Siguria përreth dhe brenda shkollës
- Ventilimi (ajrosja), ndriçimi dhe temperatura e mjediseve shkollore
- Pijet dhe ushqimet e shëndetshme në mjediset e shkollës

3.3.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Përmirësimi i mjediseve fizike të shkollës për fëmijët, duke garantuar siguri, higjenë dhe përmushjen e kushteve të nevojshme për të nxënë.

3.3.2 Nën-Objektiva

-  **Nën-Objektivi 1:** Shkolla ofron mjedise të sigurta dhe miqësore për nxënësit
-  **Nën-Objektivi 2:** Shkolla lejon përdorimin e mjediseve të shkollës, për përdorim pas orarit mësimor
-  **Nën-Objektivi 3:** Shkollat kanë klasa të profilizuar në sport.

3.3.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e shkollave që lejojnë përdorimin e mjediseve të shkollës pas orarit mësimor, për nxitjen e aktivitetit fizik.		
Përqindja e shkollave që kanë krijuar klasa sportive.		
Përqindja e nxënësve që përfitojnë nga klasat sportive.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në klasat sportive nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në klasat sportive nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		

3.3.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Shkolla lejon përdorimin e mjediseve të shkollës, për përdorim pas orarit mësimor	Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjentëve sportive të shkollës bashkë me mësuesit e lëndës së edukimit fizik.	Drejtori i IA Mësuesit e lëndës edukim fizik

2.	Shkollat kanë klasa të profilizuar në sport.	Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve që përfitojnë na këto klasa.	Mësuesit e lëndës edukim fizik
----	--	---	--------------------------------

3.3.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Shkollat të cilat nuk kanë klasa të profilizuara në sport, duhet ti krijojnë për sporte të ndryshme si gjimnastikë, atletikë etj. Numri i nxënësve që marrin pjesë duhet të raportohet sëbashku me një përshkrim të aktivitetit të zhvilluar.	
i Situata: Vihet re një rënie e numrit të shkollave ku janë hapur dhe funksionojnë klasat e profilizuara në sport, kjo si rrjedhojë e situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Hapja e klasave të profilizuara në sport, duhet realizua në mbështetje të urdhrit nr. 440, datë 2.05.2018 “Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në shkollat e arsimit bazë të sistemit parauniversitar”. Duhet raportuar numri i nxënësve që janë pjesë e këtyre aktiviteteve, si dhe tematikën e aktiviteteve.	
ii Synimi i projektit Të përfshihen dhe të përfitojnë sa më shumë nxënës nga klasat sportive, duke i nxitur të zhvillojnë sa më shumë aktivitetit fizik.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Raportimin i nxënësve që përfitojnë dhe marrin pjesë në klasat sportive.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Përfshirja e 80% të nxënësve në shkollat që kanë klasa sportive.	

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
f) Periudha e zbatimit:	g) Ndjek zbatimin e projektit:

Nr. 2	Projekti: Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive të shkollës.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Shkollat që kanë ambiente sportive, palestra apo fusha për të luajtur mund të hartojnë një plan sëbashku me mësuesit e lëndës së edukimit fizik për ti shfrytëzuar pas orarit të mësimit.	
i. Situata:	
Shumë shkolla nuk i shfrytëzojnë mjediset sportive për nxënësit dhe për fëmijët e komunitetit përreth.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Bazuar në ligjin Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, sipas Nenit 19 mbi të drejtën për pushim dhe argëtime kulturore e sportive, citohet:	
- krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare; - hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.	
Shkolla duhet të funksionojë si një qendër, ku nxënësit të mësojnë rreth bashkëpunimit dhe shërbimeve të përbashkëta, ku komuniteti të forcojë identitetin e tij dhe nivelin e konsensusit.	
Zakonisht fushat e sportit, palestra, biblioteka, laborator i informatikës, janë në dispozicion të komunitetit sipas disa kufizimeve specifike. Shkolla duke i shërbyer një mase të gjërë publiku, organizatave të shoqërisë civile, organizmave privat, mundëson shfrytëzimin e hapësirave për takime dhe aktivitete publike apo private, argëtim, rekreacion, pas mbarimit të orarit zyrtar të mësimit.	
ii Synimi i projektit	

Motivimi dhe nxitja e nxënësve të shkollës dhe të komunitetit përreth shkollës, për të zhvilluar aktivitet fizik jashtë orarit mësimor, në mënyrë që të qëndrojnë të shëndetshëm.

Kjo strategji nxit bashkëpunimin, të mësuarin ndërdisiplinar dhe krijimin e projekteve, i angazhojnë nxënësit të lëvizin, të punojnë në grup dhe të jenë aktiv.

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive nga drejtori i shkollës me mësuesit e lëndës së edukimit fizik, kundrejt një pagese simbolike nga fëmijët që do shfrytëzojnë mjediset e shkollës. Gjithashtu duke marrë leje në Bashki, konfort me ligjin.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Kjo marrëdhënie dypalëshe e shkollës me komunitetin do të sillte përfitime duke krijuar një fond të veçantë, që mund të shërbente për mirëmbajtjen e shkollës dhe zhvillimin e aktiviteteve të nxënësve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Drejtori i IA	Bashkia
Mësuesi i edukimit fizik dhe shëndet	Komuniteti

f) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

3.4 Mjedisi social në shkollë

- Projektimi i mjediseve të shkollës
- Aktivitetet e ofruara nga shkolla që kanë si qëllim edhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve
- Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- Atmosfera miqësore në shkollë
- Prania e një individi të besuar për nxënësit
- Punonjësi shëndetësor në shkollë
- Mbështetja për nxënësit me aftësi të kufizuara
- Identifikimi dhe referimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

3.4.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Shkollat kanë si qëllim promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve. Shndërrimi i shkollave në mjedis miqësor dhe jo abuzues për fëmijët.

3.4.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit

3.4.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet edukuese dhe promovuese të shëndetit nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet edukuese dhe promovuese të shëndetit nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në aktivitetet edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

3.4.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët	Sigurimi i një atmosfere miqësore dhe të sigurt për fëmijët.	Drejtori i IA ZVAP

3.4.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Organizimi i hapësirave shkollore është aspekt shumë i rëndësishëm në sigurimin e ambientit të sigurt dhe jo-abuzues për fëmijët. Pra, si është e organizuar ndërtesa, si është e organizuar brenda klase, ambienti i jashtëm i shkollës, ndriçimi etj.	
i Situata: Ka shkolla të cilat nuk kanë ndriçim të mirë, banjat nuk kanë shul por janë me çelës dhe rrezikojnë ngecjen e nxënësve brenda. Jo të gjitha shkollat kanë hapësira ku nxënësit mund të marrin shërbime, të zhvillojnë aktivitetet në mjedise të hapura pa pengesa.	

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Mjedisi miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues nënkupton krijimin e klimës pozitive në shkollë që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, social, emocional për të gjithë fëmijët. Për më tepër klima pozitive shkollore mund të çojë në ulje të mungesave, të shërbejë si një metodë e parandalimit të dukurive negative dhe të zvogëlojë efektet e pabarazive socio-ekonomike. Shkollat me mjedis të tillë, minimizojnë rastet e dhunës, ka më pak ngacmime dhe arrijnë rezultate më të mëdha akademike.	
ii Synimi i projektit Krijimi i ambienteve të sigurta, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që sigurojnë mirëqenie për fëmijët.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit 1. Mënyra e organizimit të hapësirave shkollore - Të gjitha hapësirat shkollore (klasat, korridoret, parkingjet dhe oborri i shkollës) duhet të jenë mirë të ndriçuara dhe dukshmëria është e mjaftueshme për stafin e shkollës që t'i mbikëqyrë të gjitha hapësirat me lehtësi. - Dyert e tualeteve duhet të jenë të tilla që mund të hapen nga brenda pa çelës. Kjo parandalon mbylljen e fëmijëve në tualete. - Nuk ka perde që pengojnë shikimin e hapësirave në të cilat fëmijët marrin shërbime apo hapësira ku dikush mund t'i çojë fëmijët.	
c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Shkollat duhet të kenë: 1. Hapsira të ndriçuara mirë, të cilat mbikqyren lehtësisht 2. Dyer me shul nga brenda, të cilat nuk rrezikojnë ngecjen e nxënësve 3. Hapsirat ku marrin shërbime fëmijët janë të hpura pa pengesa	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

d) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)

Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)
Shuma:	

e) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

3.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit

- Shkolla zbaton programe që nxisin zhvillimin e aftësive individuale dhe përvetësimin e njohurive mbi shëndetin
- Shkolla ka rregulla të qarta që nxisin sjellje të shëndetshme

3.5.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Të nxitë aftësitë e nxënësve për të përmirësuar shëndetin në shkollë.

3.5.2 Nën-Objektiva

 **Nën-Objektivi 1:** Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmoshatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë njëri-tjetrin.

 **Nën-Objektivi 2:** Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme.

3.5.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		

Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e shkollave që kanë hartuar një rregullore mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë		

3.5.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmoshatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë njëri-tjetrin.	Mësuesit organizojnë nxënësit, për të zhvilluar aktivitete ku nxënësit kryejnë edukim bashkëmoshatar.	Mësuesit dhe nxënësit
2.	Shkolla ka një rregullore që nxit nxënësit drejt sjelljeve të shëndetshme.	Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme në shkollë.	Drejtori i IA, mësuesit dhe nxënësit

3.5.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Edukimi bashkëmoshatar (peer-to-peer education)
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Edukimi mes bashkëmoshatarëve mbështetet në idenë se “të rinjtë janë ekspertë të jetës së tyre dhe për këtë arsye janë pikënisja më e mirë në çdo proces mësimor”.	
i. Situata: Në shkolla nuk janë zhvilluar orë ku nxënësit të jenë edukuesit e bashkëmoshatarve të tyre mbi sjelljet e shëndetshme. Mësuesit janë ata që shpjegojnë dhe ndajnë informacionin me nxënësit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Një ndër format më të mira për të mësuar mbi sjelljet e shëndetshme është nëpërmjet përvojave nga njëri-tjetri, në këtë mënyrë nxënësit bëhen edukatorë të bashkëmoshatarëve dhe inkurajohen që t’ua përcjellin informacionin të tjerëve në mënyrë që të gjenerojnë ndryshim midis anëtarëve të tjerë të të njëjtit grup.	

ii Synimi i projektit Të edukojmë fëmijët mbi sjelljet e shëndetshme nëpërmjet përvojave dhe eksperiencave të ndara midis njëri-tjetrit.
iii Aktivitetet kryesore të projektit Organizimi i nxënësve pas orës mësimore ose gjatë orëve të lira, me ndihmën e mësuesve, për të zhvilluar temat mbi sjelljet e shëndetshme. Gjatë këtyre orëve nxënësit do të shpjegojnë, do të japin informacion dhe përvoja të tyre mbi sjelljet e shëndetshme dhe promovimin e shëndetit në shkollë.
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Rritje të kapaciteteve dhe njohurive të nxënësve mbi sjelljet e shëndetshme dhe promovimin e shëndetit nëpërmjet edukimit bashkëmoshatar. Si dhe një përfshirje të madhe të nxënësve në këto aktivitete.

Nr. 2	Projekti: Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Për hartimin e rregullores duhet të bashkëpunojnë disa aktorë si mësuesit, punonjësit social/psikologë, komisioni i shëndetit, oficeri i sigurisë, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve etj.	
i. Situata: Në shumicën e shkollave mungon një rregullore e dedikuar sjellejeve të shëndetshme, e cila ndalojë dukuritë jo të shëndetshme (si dhuna, abuzimi etj) dhe nxit fëmijët drejt promovimit të shëndetit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Shkolla gjatë hartimit të rregullores duhet të ketë parasysh pikat e mëposhtme: • rregullat e sjelljes që ndalojnë dukuritë jo të shëndetshme dhe vazhdimisht e monitoron zbatimin e tyre • duhet të sigurojnë zbatimin e kësaj rregullore e cila përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ që frekuenton shkollën • duhet të realizojë aktivitetet jashtë-kurrikulare, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës, abuzimit dhe promovimit të sjellejeve të shëndetshme.	
ii Synimi i projektit Shkolla duhet të ketë një rregullore e cila të ndalojë dhunën dhe abuzimin midis nxënësve si dhe të nxisi sjelljet e shëndetshme, si psh ndalimi i konsumit të pijeve të gazuara apo me sheqer në ambientet e shkollës.	

iii Aktivitetet kryesore të projektit

Bashkëpunimi i aktorëve kryesorë për të hartuar rregulloren.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Nxënësit duke zbatuar rregulloren do të prirën drejt sjelljeve të shëndetshme, dhe mësuesit do e kenë më të thjelltë monitorimin e tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Nxënësit, mësuesit.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
---	---

3.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë

- Pjesëmarrja dhe perfshirja e prindërve
- Lidhja e shkollës me biznese lokale, klube sportive lokale, dhe me Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
- Organizimi i vizitave tek bizneset lokale për të forcuar sjelljet e shëndetshme

3.6.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor:

Përfshirja e prindërve dhe më gjerë në aktivitetet që zhvillon shkolla mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

3.6.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Lidhja e shkollës me NJVKSH-të për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.

3.6.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e shkollave që kanë Bordin e Prindërve funksional.		
Numri i aktiviteteve që zhvillon bordi i prindërve në zonat urbane në vit.		
Numri i aktiviteteve që zhvillon bordi i prindërve në zonat rurale në vit.		

Numri i aktiviteteve që NJVKSH ka zhvilluar me shkollat.		
Numri i aktiviteteve që janë organizuar në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë nga zona urbane dhe nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		

3.6.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesëmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.	Shkollat ngrenë Bordin e prindërve, të cilët marrin pjesë në aktivitetet që shkolla zhvillon me fokus sjelljet e shëndetshme	Drejtori i IA Prindërit
2.	Lidhja e shkollës me NJVKSH-të për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.	Shkolla bashkëpunon me NJVKSH për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin	Drejtori i IA NJVKSH-ja

3.	Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme	Shkolla bashkëpunon me komunitetin përreth, biznese, klube sportive etj për të organizuar aktivitete për të nxitur nxënësit të qëndrojnë të shëndetshëm.	Drejtori i IA Komuniteti
----	--	--	--------------------------

3.6.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Pasi ngrihet Bordi i Prindërve në çdo shkollë, zhvillohet një takim ku diskutohet dhe merret mendimi i prindërve mbi aktivitetet që ata mund të kontribuojnë me fokus shëndetin.	
i Situata:	
Bordi i Prindërve është i ngritur në shumicën e shkollave, por nuk merr pjesë në zhvillimin e aktiviteteve me fokus shëndetin e fëmijëve.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Bordi i Prindërve pasi ngrihet, duhet të zhvillojë minimumi 3 mbledhje në vit, ku prindërit të jetë pjesmarrës aktiv në të gjitha aktivitetet që shkolla zhvillon me fokus shëndetin. Pjesë e bordit duhet të jetë një anëtar nga komuniteti, gjatë përzgjedhjes së këtij anëtar, mund ti jepet prioritet një personi që mund të jetë mjek, infermier, psikolog/ punonjës social, policë, zjarrfikës etj, pasi ata mund të ofrohen të zhvillojnë orë të lira me nxënësit mbi sjelljet e shëndetshme	
ii Synimi i projektit	
Angazhimi i prindërve në aktivitetet me fokus shëndetin e fëmijëve.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit	
Aktiviteti i parë është ndërtimi i një kalendari aktiviteteve ku prindërit janë pjesmarrës aktiv. Më pas duhet të bëhet raportimi pas çdo aktiviteti ku të detajohet numri i nxënësve që kanë marrë pjesë, gjinia e tyre si dhe etnia.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	
Numër të lartë të prindërve të përfshirë në aktivitete si dhe përqindje të lartë të fëmijëve që kanë përfituar nga këto aktivitete.	

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

Nr. 2	Projekti: Bashkëpunim me NJVKSH për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Shkolla bashkëpunon me NJVKSH për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin.	
i. Situata:	
NJVKSH-të hartojnë kalendarin e aktiviteteve në shkolla dhe zhvillojnë takime informuese me nxënësit, por këto takime nuk i përfshijnë aktivisht nxënësit në veprimtari për ti aftësuar, prandaj sygjerojmë shtimin e aktiviteteve promovuese të shëndetit, si dhe zhvillimi i fushatave sensibilizuese.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Shërbimi shëndetësor në shkolla ka karakter parandalues. Ai ka për qëllim sigurimin e një zhvillimi normal fizik dhe mendor të fëmijëve të shkollës. Qëllimi kryesor është bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në shkolla, nëpërmjet informimit, edukimit, komunimit për përfitimin e sjelljeve të shëndetshme tek fëmijët e moshës 6-16 vjeç. NJVKSH duhet të bashkëpunojë dhe me psikologun/punonjësin social, stafin mësimor, bordin e shkollës dhe komunitetin, për të zhvilluar aktivitete me fokus sjelljet e shëndetshme.	
ii Synimi i projektit	
Rritja e kapacitetit dhe edukimi i fëmijëve nga stafi i NJVKSH mbi sjelljet e shëndetshme dhe promocionin shëndetësor.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit	
Organizimi i aktiviteteve me NJVKSH në bazë të kalendarit të shëndetësisë dhe aktivitetet të rakordohem me planet e aktiviteteve në shkolla, në mënyrë që të kemi një qasje dhe një përfshirje më të gjerë të nxënësve që marrin pjesë.	
c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	
Numër të lartë aktiviteteve të zhvilluara si dhe përqindje të lartë të fëmijëve që kanë përfituar nga këto aktivitete.	
Bashkëpunimi i NJVKSH me ZVAP për të analizuar të dhënat e marra nga matjet dhe aktivitetet e zhvilluara me nxënësit.	

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

Nr. 3	Projekti: Zhvillimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme-Shkolla Qendër Komunitare
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Shndërrimi i shkollave në vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet me fokus zhvillimin akademik, social, fizik, dhe emocional të fëmijës duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron familja dhe komuniteti.	
i. Situata:	
Sistemi jonë arsimor ka nevojë për shkollat komunitare, sepse vëzhgimet e kryera dhe përvoja ka treguar që fëmijet dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Shkollat, familjet dhe komuniteti sot përballen me një sfidë të përbashkët, që është edukimi cilësor për fëmijët e të rinjtë si dhe mundësi për t'iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve me tematika të përbashkëta duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre. Shkollat, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:	
• për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet • për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale • për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.	
ii Synimi i projektit	
Shkolla si qendër komunitare synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit	

• Shkolla organizon aktivitete që kanë si qëllim forcimin e marrëdhënieve: komunitet-nxënës-mësues. • Shkolla ndërgjegjëson komunitetin për rëndësinë e respektimit të diversitetit • Shkolla në bashkëpunim edhe me sektorët e shëndetit publik ofron kurse për këshillim familjar. • Shkolla ofron shërbime psikologjike, sociale, ligjore në rast nevojë të komunitetit. • Shkolla përgatit komunitetin për strategjitë e ndërhyrjeve në rastin e emergjencave natyrore.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Fokusi i shkollave qendër komunitare është të ndihmojë në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbështetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Nr. 4	Projekti: Pjesmarrja aktive e komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në aktivitete
d) Përshkrim i shkurtër i projektit: Organizon veprimtari ndërgjegjësuere me fëmijët, mësuesit dhe prindërit për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjedisve e pajisjeve të institucionit.	
i Situata: Bazuar në urdhërin nr. 31 datë 28.01.2020- “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, çdo shkollë duhet të ketë të ngritur Komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit. Shkollat e kanë ngritur Komisionin e shëndetit , por ai nuk është funksional në të gjitha shkollat, për të përmbushur përgjegjësitë e tij.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Përgjegjësitë e Komisionit të shëndetit janë: • Mbikëqyr rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së fëmijëve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjedisve dhe të pajisjeve. • Identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit. • Përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve. • Propozon procedurat ditore dhe javore të higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së IA-së, të cilat miratohen nga drejtori i institucionit. • Drejton hartimin e rregullores së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.	
ii Synimi i projektit	

Përmbushja e përgjegjësisë dhe pjesëmarrja aktive e Komisionit të shëndetit në aktivitetet me nxënësit dhe komunitetin e prindërve.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Komisioni i Shëndetit duhet të organizojë veprimtari dhe të ketë pjesëmarrje aktive në aktivitetet që kryen bordi i prindërve dhe NJVKSH, me fokus sjelljet e shëndetshme në shkollë.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Pjesëmarrje e lartë e nxënësve të shkollës të përfshirë në veprimtari ndërgjegjësuere të zhvilluara nga Komisioni i Shëndetit. Përpara zhvillimit të aktiviteteve në bashkëpunim me OJF të merret leje nga DPAP, për zhvillimin e tyre.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Anëtarët e Komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

3.7 Stafi i shkollës

Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.

Më poshtë janë përmendur 7 standardet të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e mësuesit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e mësuesit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të reja kurrikulare; si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive në shkollë ndërmjet drejtuesve, stafit pedagogjik, prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit.

Standardi 1. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional

Standardi 2. Zotërimi i përmbajtjes së dokumentacionit kurrikular

Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës

Standardi 4. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies

Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit

Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

- Shkolla i ofron mësuesve trajnime dhe rritje të kompetencave profesionale në lidhje me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla ka burime të mjaftueshme për të ofruar materiale të përditësuara në lidhje me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla krijon një balancë midis punës dhe jetës private, siguron një ngarkesë pune të përballueshme dhe i ofron mundësi stafit për të diskutuar probleme të ndryshme
- Mësuesve të rinj u ofrohen trajnime për rritjen e tyre profesionale në drejtim të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies
- Përballimi i mungesave të personelit dhe ri-integrimi i stafit mësimor
- Shkolla mbështet stafin në arritjen dhe mbajtjen e një mënyre jetese të shëndetshme

3.7.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Rritja e njohurive dhe aftësive të mësuesve për të promovuar sjellje të shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.

3.7.2 Nën-Objektiva

-  **Nën-Objektivi 1:** Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.
-  **Nën-Objektivi 2:** Ofrimi i trajnimeve për stafin shëndetësor (mjekë/infermier) mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.

 **Nën-Objektivi 3:** Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.

3.7.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e mësuesve që janë trajnuar në platformën e-Learning.		
Përqindja e stafit shëndetësor që janë trajnuar për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.		
Numri i psikologë, punonjës social në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i mjekë/infermierë në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i oficerë sigurie në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë.		

3.7.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.	Regjistrimi i mësuesve në platformën e-Learning për të zhvilluar trajnime online, si edhe zhvillimi i trajnimeve fizike.	Drejtori i IA ZVAP Projekti “Shkollat për Shëndetin”
2.	Ofrimi i trajnimeve për stafin shëndetësor mbi promovimin e sjelljeve të	Zhvillimi i trajnimeve online ose fizik me stafin shëndetësor të NJVKSH, për të promovuar sjelljet e shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç	Drejtori i IA Projekti “Shkollat për Shëndetin”

	shëndetshme në shkollë.		
3.	Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.	Mbulimi me aktivitete të promocionit shëndetësor në shkollat e terrorit (mjekët/infermierët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP NJVKSH Drejtori i IA
		Mbulimi me shërbim psiko-social në shkollat e terrorit (punonjësit social/psikologët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP Drejtori i IA

3.7.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Zhvillimi i trajnimeve online në platformën e-Learning
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Regjistrimi i mësuesve në platformën e-Learning dhe zhvillimi i moduleve të trajnimit.	
i Situata: Sipas udhëzimit Nr.16 datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” duhet që: Punonjësit arsimorë të trajnohen 18 orë në vit, të cilat pasqyrojnë 1 kredit. Jo të gjithë mësuesit arrijnë të plotësojnë normën e 1 krediti në vit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Platforma e-Learning është krijuar për të ardhur në ndihmë stafit mësimor, që të kenë mundësi të zhvillojnë trajnime online në çdo kohë. Momentalisht në të janë 5 module trajnimi: - Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm në kurrikulën shkollore të grupmoshës 6-16 vjeç. - Rëndësia e aktiviteti fizik dhe shëndeti të nxënësit të moshës 6-16 vjeç, për të promovuar një stil jetese të shëndetshme. - Promovimi i rëndësisë të shëndetit mendor të nxënësit të moshës 6-16 vjeç. - Edukimi seksual gjithëpërfshirës. - Higjiena personale, parandalimi i sëmundjeve infektive të nxënësit të moshës 6-16 vjeç dhe mbrojtja e mjedisit.	
ii Synimi i projektit	

Synimi i trajnimeve online është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të stafit mësues mbi sjelljet e shëndetshme, në mënyrë që t'ju sigurojë të gjithë nxënësve shërbim arsimor cilësor.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit	
Trajnimi i mësuesve se si të aksesojnë platformën e-Learning online, si të regjistrohen në të dhe si të zhvillojnë modulën e trajnimit.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	
Të gjithë mësuesit të jenë regjistruar në platformën e-Learning për të ndjekur trajnime online.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Drejtori i IA dhe mësuesit	Projekti “Shkollat për Shëndetin”

Nr. 2	Projekti: Zhvillimi i trajnimeve online ose fizikisht me stafin shëndetësor të shkollës, për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:	
Pjesëmarrja e stafit shëndetësor në trajnimet mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.	
i. Situata:	
Stafi shëndetësor në shkollë nuk zhvillon trajnime të vazhdueshme për të rritur kapacitetin e tyre rreth promovimit të sjelljeve të shëndetshme në shkollë, prandaj shihet e nevojshme kryerja e trajnimeve.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Mënyra se si transmetohet mesazhi mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, në grupmoshat e reja është tepër delikat, prandaj zhvillimi i trajnimeve rrit kapacitetet menaxhuese të temave mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.	
Stafi shëndetësor aftësohet dhe mund të trajnoj dhe mësuesit për të shtuar tema mbi promovimin shëndetësor në temat mësimore.	
ii Synimi i projektit	
Synimi i trajnimeve online/fizikisht është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të stafit shëndetësor mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, në mënyrë që të nxisin nxënësit drejt sjelljeve të shëndetshme.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit	
Përfshirja e gjithë stafit shëndetësor të shkollës në trajnimet për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.	
c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	

Të gjithë pjesëtarët e stafit shëndetësor në shkollë të jenë trajnuar rreth promovimit të sjelljeve të shëndetshme në shkollë.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA dhe stafi shëndetësor	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj) Projekti “Shkollat për Shëndetin”

Nr. 3	Projekti: Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Burimet njerëzore që disponojmë duhet të përdoren në mënyrë sa më efektive, nëpërmjet organizimit shumë të mirë me anë të zonave të përcaktuara, stafi shëndetësor duhet të ketë mundësi tju shërbejë dhe shkollave të tjera, kur kanë emergjencë.	
i Situata Disponueshmëria e mjekëve, infermierëve dhe/ose e personelit tjetër shëndetësor në shkollë është e pakët, veçanërisht në zonat e thella rurale në shumicën e qarqeve të vendit. Nga kjo mangësi e stafit shëndetësor në shkollë, shihet e domosdoshme organizimi i burimeve njerëzore në një shpërndarje të drejtë midis shkollave në zonat urbane dhe në ato rurale, si dhe për tu shfrytëzuar aty ku ka më shumë nevojë.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Shpërndarja e burimeve njerëzore aty ku ka më shumë problematika dhe rakordimi i orarit të qëndrimit në disa shkollë pranë njëra –tjetrës do ishte tepër efektive. Në këtë mënyrë çdo shkollë do të ketë afër asistencën e stafit shëndetësor në çdo moment emergjence, apo problematike.	
ii Synimi i projektit Nëpërmjet këtij organizimi të gjitha shkollat kanë mundësi të disponojnë një pjesë të kohës stafin shëndetësor (mjek/infermier, punonjës social/psikologë) në shkollat e tyre dhe kanë mundësi të lajmërojnë në çdo moment emergjence kur nuk janë të pranishëm në shkollë.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Riorganizimi dhe rishpërndarja e stafit shëndetësor për të mbuluar deri në 4 shkollë në një largësi të afërt nga njëra tjetra, ku çdo ditë të vizitojë 2 shkollë, dhe të ketë mundësi të aksesojë në pak kohë shkollat nga njëra tjetra.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Riorganizimi i burimeve njerëzore dhe përdorimi sa më eficient i tyre.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Stafi shëndetësor, Drejtori i IA, ZVAP	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

3.8 Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

- ✚ Planet afatmesme të shkollës lidhur me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- ✚ Planet vjetore të shkollës lidhur me promocionin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- ✚ Drejtorja e shkollës monitoron shërbimin psiko-social
- ✚ Drejtorja e shkollës monitoron shërbimin shëndetësor
- ✚ Drejtorja e shkollës monitoron shërbimin e pastrimit dhe higjienës
- ✚ Drejtorja e shkollës bashkëpunon me institucionet e edukimit, shëndetësisë, dhe qeverisjes lokale
- ✚ Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit
- ✚ Pjesëmarrja e Bordit të Shkollës, Këshillit të Prindërve, dhe Qeverisë së Nxënësve
- ✚ Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës punojnë aktivisht për të zgjidhur ankesat e nxënësve në lidhje me shëndetin, me mirëqenien dhe me veprimtaritë fizike

3.8.1 Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor: Monitorimi dhe dokumentimi/raportimi periodik i shërbimeve të promocionit shëndetësor në shkollë nga drejtori i institucionit arsimor tek ZVA.

3.8.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Hartimi i një dokumenti ku raportohet çdo veprimtari që zhvillon shërbimi psiko-social, shërbimi shëndetësor, shërbimi i pastrimit dhe higjienës, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Qeveria e Nxënësve dhe Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës.

3.8.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimet e promocionit shëndetësor në shkollë, tek ZVA.		
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin psiko-social në shkollë, tek ZVA.		
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin e pastrimit dhe higjienës në shkollë, tek ZVA.		

3.8.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Raportimi periodik i monitorimit të shërbimeve: • psiko-social, • shëndetësor, • i pastrimit dhe higjenës, • Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, • Bordi i Shkollës, • Këshillit të Prindërve, • Qeverisë së Nxënësve • Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës	-Të merret leje në DPAP përpara zhvillimit të aktiviteteve me OJF apo organizata të tjera - Të dokumentohet procesi i kontaktit të institucionit arsimor me OJF. - Të dokumentohet monitorimi i të gjitha shërbimeve të promocionit shëndetësor nga drejtori. - Të raportohet monitorimi i punës dhe i aktiviteteve që zhvillojnë bordi i shkollës dhe komisionet e ngritura.	Drejtori i IA

3.8.5 Lista e projekteve

Nr. 1	Projekti: Raportimi në mënyrë periodike i aktiviteteve të monitoruara nga drejtuesi i institucionit arsimor.
a) Përshkrim i shkurtër i projektit: Hartimi i një dokumenti të thjeshtë ku të raportohet periodikisht çdo shërbim.	
i Situata Bazuar në Urdhërin Nr.31, datë 28.01.2020 për “Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” citohet sipas: <i>Neni 9- Veprimtaritë plotësuese</i> Veprimtaritë plotësuese, që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument në të cilin tregohet synimi i veprimtarisë, pjesëmarrja dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj. <i>Neni 66- Plani afatmesëm</i> Drejtori i shkollës i raporton një herë në vit bordit të shkollës për zbatimin e planit afatmesëm. Ndryshimet në planin afatmesëm miratohen nga bordi i shkollës.	

<i>Neni 117- Siguria</i> 1. Drejtori harton raportin për çdo rast emergjence në institucion. 2. Drejtori i institucionit arsimor publik formulon periodikisht ose në kohë reale me sistem elektronik, për njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, kërkesën e detajuar për mirëmbajtjen e institucionit, bazuar në pyetësonin e mirëmbajtjes.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Drejtori i shkollës e ka për detyrë të monitorojë dhe të raportoj në mënyrë periodike shërbimet në shkollë si dhe çdo aktivitet që kryhet në shkollë.	
ii Synimi i projektit Shkolla duke u bazuar në rregulloret e brendshme dhe në obligimet ligjore, duhet të raportoj në mënyrë periodike.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Raportimi në mënyrë periodike për çdo aktivitet nga drejtori tek ZVAP.	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) Rritja e kapaciteti raportues në nivel shkolle.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtuesi i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit Vjetor të Përmirësuar me fokus Shëndetin


Plani i përmirësimit i ZVAP me fokus shëndetin do të do të monitorohet përmes një grupi treguesish bazë në fillim dhe në fund të çdo viti, në përputhje me objektivat e parashikuara në Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Strategjigjë Kombëtare dhe me Planet e Veprimit në fushën e Arsimit, deklaratat e OBSH-së mbi promocionin e shëndetit, si dhe me Strategjinë e Re Kombëtare Shqiptare për Shëndetin 2021-2030; Planin e Veprimit të SJT 2021-2030; Planin e Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2022-2030 dhe strategjitë dhe angazhimet e tjera kombëtare ekzistuese.

Plani parasheh në mënyrë konkrete matjen e secilit tregues. Të dhënat do të mbledhen nga institucionet përgjegjëse (kryesisht shkollat) për aktivitete të veçanta, si dhe nga vlerësimet e standardizuara me mbështetjen e projektit “Shkollat për Shëndetin”. Vlerat fillestare dhe objektivat vjetore për të gjithë treguesit janë përcaktuar në dokument.


Një rishikim i këtij Plani mund të bëhet në mes të periudhës së zbatimit gjatë viteve të para në mënyrë që të ofrohet mbështetje dhe të ndërhyhet në kohë reale për përmirësimin e efektivitetit të aktiviteteve që lidhen me promocionin shëndetësor.


5. Aneks 1. Raport mbi rezultatet e programit të kontrollit mjekësor bazë (check-up) në rajonin e Beratit

Shpërndarja e individëve sipas gjinisë




Shpërndarja e individëve sipas gjinisë dhe grup-moshës







Koment: Në Berat, prevalenca e mbipeshës dhe obezitetit është 74%, pra pothuajse e njëjtë me vlerën mesatare në nivel kombëtar (75%).




Koment: në Berat, prevalenca e HTA është 49.2%, pra pak më e lartë se vlera mesatare në nivel kombëtar (46%).



Koment: Në Berat, prevalenca e nivelit të lartë të sheqerit në gjak është 20.9%, pak më e ulët se vlera mesatare në nivel kombëtar (24.5%).



Koment: Në Berat, prevalenca e azotemisë së lartë është 2.3%, pra pothuajse e njëjtë me vlerën mesatare në nivel kombëtar (2.5%).



Koment: Në Berat, prevalenca e kreatinemisë së lartë është 1.09%, pra pothuajse e njëjtë me vlerën mesatare në nivel kombëtar (1,07%).